

UDHËZUES PËR MIRADMINISTRIM TË AKTIVITETEVE MINERARE DHE MJEDISORE



UDHËZUES PËR MIRADMINISTRIM TË – AKTIVITETEVE MINERARE DHE MJEDISORE

Iniciativa e përbashkët ndërinstitucionale

1. KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE.
2. MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
3. AGJENCIA E PYJEVE TË KOSOVËS
4. MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL- ASOCIACIONI I KOMUNAVE



1. POLICIA E KOSOVËS

PËRMBAJTJA:

UDHËZUES PËR MIRADMINISTRIM TË AKTIVITETEVE MINERARE DHE MJEDISORE	1
HYRJE.....	10
DISPOZITA LIGJORE – LIDHUR ME PARANDALIMIN E DEGRADIMIT MJEDISOR	11
KLASIFIKIMI I OPERIMEVE LEGALE MINIERARE- KPMM	14
LICENCAT E HULUMTIMIT-KPMM	20
LICENCAT E SHFRYTËZIMIT- KPMM.....	21
LEJET E AKTIVITETVE TË VEÇANTA- KPMM.....	22
KLASIFIKIMI I OPERIMEVE ILEGALE MINIERARE - KPMM.....	31
AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË HULUMTIM - KPMM	36
AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË SHFRYTËZIM- KPMM.....	36
AKTIVITETET ILEGALE ME PASOJA DEGRADUESE AMBIENTALE DHE SHKAKTIMI I RREZIKUT -KPMM	37
VEPRIMTARIA E JASHTËLIGJSHME NË AKTIVITET TË VEÇANTA- KPMM	51
PASURIMI (FLOTACIONET dhe PASURIMET E THËNGJILLIT)-KPMM.....	54
BAZA LIGJORE - MMPH.....	56
PËLQIMET, LICENCAT APO LEJET-MMPH.....	57
PROCEDURAT E LESHIMIT NJE PELQIMI APO LEJE-MMPH	78
KLASIFIKIMI I OPERIMEVE ILEGALE MINIERARE-MMPH.....	83
AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË HULUMTIM-MMPH.....	86
AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË SHFRYTËZIM-MMPH	86
AKTIVITET ILEGALE ME PASOJA DEGRADUESE AMBIENTALE DHE SHKAKTIMI I RREZIKUT-MMPH	87
VEPRIMTARIA E JASHTËLIGJSHME NË AKTIVITET TË VEÇANTA-MMPH.....	99
PËRPUNIMI (BAZA BETONI DHE ASFALTI)-MMPH.....	101
PASURIMI (FLOTACIONET dhe PASURIMET E THËNGJILLIT)-MMPH	103
AKTIVITETET DEGRADUESE MJEDISORE NGA KOMPANITË QË POSEDOJNË LEJE TË AKTIVITEVE TË VEÇANTA – MMPH.	104

BAZA LIGJORE - APK	109
PËLQIMET, KONTRATAT-APK	112
KLASIFIKIMI I OPERIMEVE ILEGALE MINIERARE NË PYJE DHE TOKA PYJORE- APK	117
AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË HULUMTIM-APK	117
AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË SHFRYTËZIM- APK	117
AKTIVITETET ILEGALE ME PASOJA DEGRADUESE AMBIENTALE DHE SHKAKTIMI I RREZIKUT-APK	118
DISPOZITA LIGJORE – LIDHUR ME INSPEKTORATET KOMUNALE, PARANDALIMI DHE KONTROLLA - MAPL	124
PËLQIMET, LEJET dhe KONTRATAT - KOMUNAT	126
KLASIFIKIMI I OPERIMEVE ILEGALE MINIERARE - INSP. KOMUNAL	131
AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË HULUMTIM-INSP. KOMUNAL	131
AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË SHFRYTËZIM- INSP. KOMUNAL	131
AKTIVITET ILEGALE ME PASOJA DEGRADUESE AMBIENTALE DHE SHKAKTIMI I RREZIKUT - INSP. KOMUNAL	132
VEPRIMTARIA E JASHTËLIGJSHME NË AKTIVITET TË VEÇANTA- INSP. KOMUNAL	147
AKTIVITETET DEGRADUESE MJEDISORE NGA KOMPANITË QË POSEDOJNË LEJE TË AKTIVITEVE TË VEÇANTA - INSP. KOMUNAL	150
POLICIA E KOSOVËS.....	155

Lista e figurave:

Figura 1 Makina e shpuarjeve të thella - KPMM.....	14
Figura 2 Metoda e hulumtimit gjeofizike - KPMM.....	15
Figura 3 Metoda e hulumtimit me kanale hulumtuese - KPMM.....	16
Figura 4 Gurëthyesi me seperacion - KPMM	17
Figura 5 Impianti i Betonit- KPMM.....	18
Figura 6 Impianti për përgatitjen e Asfaltit - KPMM	18
Figura 7 Impianti i pasurimit të mineraleve- Flotacioni - KPMM	19
Figura 8 Forma e një licence të hulumtimit - KPMM.....	20
Figura 9 Forma e një licence të shfrytëzimit - KPMM	21
Figura 10 Forma e një leje të aktiviteteve të veçanta- KPMM.....	22
Figura 11 Modeli i vjetër i licencave dhe lejeve faqja e parë dhe faqja e fundit e licencës së modelit të vjetër- KPMM.....	23
Figura 12 Largimi i mbulesës si fazë përgatitore e fillimit të punëve minerare- KPMM.....	24
Figura 13 Aktiviteti i përgatitjes së fushës për minim - KPMM.....	25
Figura 14 Aktiviteti minerar përgatitja e fushës për minim - KPMM.....	25
Figura 15 Fillimi i ndërtimit një shkalle punuese minerare - KPMM	26
Figura 16 Shkallët përfundimtare - KPMM	27
Figura 17 Ri-kultivimi i shkallëve të minierës me ri-kultivim - KPMM	27
Figura 18 Shfrytëzimi ilegal në lumenj dhe prishja e shtratit të lumit - KPMM	39
Figura 19 Dëmtimi i arave përreth nga shfrytëzimi i rërave në toka punuese.....	40
Figura 20 Ri kultivimi-mbushja me bërllok i gropave të shfrytëzuara -kontaminimi i tokës me mbetje urbane - KPMM	41

Figura 21 Krijimi i pellgjeve me ujë si pasojë e shfrytëzimit të rërave - KPMM	42
Figura 22 Shfrytëzimi i inerteve në lum, dëmtimi i shtresës dyshemore të shtratit të lumit - KPMM.	43
Figura 23 Krijimi i deponisë me grumbull uji dhe dëmtim i kufirit të arave përreth - KPMM.....	44
Figura 24 Deponi uji nga shfrytëzimi i argjilave dhe rërave, pellgje degraduese dhe rrezik për njerëz - KPMM.....	45
Figura 25 Shfrytëzimi i qymyreve ku shfrytëzimi bëhet pa kriter duke dëmtuar ambientin, shkaktim i rrezikut dhe dëmtim i pronave përreth vend-shfrytëzimit - KPMM.	47
Figura 26 Shfrytëzimi pa kriter, krijim lartësisë së shkallëve dhe mungesa e ri-kultivimi - KPMM.....	47
Figura 27. Shfrytëzimin operatori ilegal nuk ka arritur ta bëjë në thellësi dhe ka arritur vetëm ta shfrytëzojë atë shtresë që i ka lejuar makineria. Degradim i terrenit dhe prishje e ambientit - KPMM	49
Figura 28 Dëmtim i ambientit dhe rrezikim i shkallëve përfundimtare si shfrytëzim pa kriter - KPMM	50
Figura 29 Aktiviteti i një seperi ilegal dhe marrja e resursit (rërës) në mënyrë ilegale - KPMM.....	52
Figura 30 Aktiviteti ilegal i bazës së betonit dhe shfrytëzimi i resursit të përpunuar nga seperacionet - KPMM.....	53
Figura 31 Aplikacioni për kushte ujore – MMPH	Figura 32 Aplikacioni për Pëlqim Ujorë - MMPH.....
Figura 33 Aplikacioni për Leje Ujore – MMPH	Figura 34. Forma e një Vendimi (Leje ujore, Pëlqim Ujore, Kushte Ujore) MMPH.....
Figura 35 Largimi i mbulesës si fazë përgatitore e fillimit të punëve minerare - MMPH	80
Figura 36 Aktiviteti i përgatitjes së fushës për minim - MMPH.....	80
Figura 37 Aktiviteti minierar përgatitja e fushës për minim - MMPH.....	81
Figura 38 Fillimi i ndërtimit një shkallë punuese minerare - MMPH.....	81
Figura 39 Shkallët përfundimtare - MMPH.....	82
Figura 40 Ri-kultivimi i shkallëve të minierës me ri-kultivim - MMPH.....	82
Figura 41 Shfrytëzimi ilegal në lumenj dhe prishja e shtratit të lumit - MMPH.....	89
Figura 42 Dëmtimi i arave përreth nga shfrytëzimi i rërave në toka punuese - MMPH.....	90

Figura 43 Ri kultivimi-mbushja me bërlllok i gropave të shfrytëzuara -kontaminimi i tokës me mbetje urbane - MMPH.....	91
Figura 44 Krijimi i pellgjeve me ujë si pasojë e shfrytëzimit të rërave - MMPH.....	91
Figura 45 Shfrytëzimi i inerteve në lum, dëmtimi i shtresës dyshemore të shtratit të lumit - MMPH.....	92
Figura 46 Krijimi i deponisë me grumbull uji dhe dëmtim i kufirit të arave përreth - MMPH	93
Figura 47 Deponi uji nga shfrytëzimi i argjilave dhe rërave, pellgje degraduese dhe rrezik për njerëz - MMPH.....	94
Figura 48 Shfrytëzimi i qymyreve i cili bëhet pa kriter duke dëmtuar ambientin, shkaktim i rrezikut dhe dëmtim i pronave përreth vend-shfrytëzimit – MMPH.	96
Figura 49 Shfrytëzimi pa kriter, krijim lartësisë së shkallëve dhe mungesa e ri-kultivimi - MMPH.....	96
Figura 50. Shfrytëzimin operatori ilegal i cili nuk ka arritur ta shfrytëzojë në thellësi por vetëm atë shtresë nga makineria. Degradim i terrenit dhe prishje e ambientit - MMPH.....	98
Figura 51 Dëmtim i ambientit dhe rrezikim i shkallëve përfundimtare si shfrytëzim pa kriter – MMPH.....	99
Figura 52 Aktiviteti i një seperi ilegal dhe marrja e resursit (rërës) në mënyrë ilegale - MMPH	100
Figura 53 Aktiviteti ilegal i bazës së betonit dhe shfrytëzimi i resursit të përpunuar nga sepracionet - MMPH	102
Figura 54 Degradimi i ambientit nga pluhuri - MMPH	106
Figura 55 Degradimi i ndodhur në vazhdimësi dhe gjendja faktike e ndotur mjedisore përreth impiantit - MMPH.....	107
Figura 56 Sistemi efikas i punës së sepracioneve duke përdorur sistemin e spërkatjes apo sistemin ventilues – MMPH.....	108
Figura 57 Foto nga shqyrtimi i kërkesës nga komisioni për ndërrim të destinimit të tokës pyjore	116
Figura 58 Heqja e shtresës së bimësisë bimë (drunore e barishtore) me efektet negative të sipërpërmendura - APK	119
Figura 59 Efektet nga shfrytëzimi ilegal ku dëmtohen pyjet si pasuri kombëtare dhe biodiversiteti foto 2 – APK.	120
Figura 60 Largimi i mbulesës si fazë përgatitore e fillimit të punëve minerare	127
Figura 61 Aktiviteti i përgatitjes së fushës për minim.	127
Figura 62 Aktiviteti minierar përgatitja e fushës për minim.....	128

Figura 63 Fillimi i ndërtimit një shkalle punuese minerare.....	128
Figura 64 Shkallët përfundimtare, është në përgjegjësi tjera institucionale- Insp. Komunal	129
Figura 65 Rikultivimi i shkallëve të minierës me ri kultivim e aprovuar nga institucionet përgjegjëse –Insp komunal.....	130
Figura 66 Shfrytëzimi ilegal në lumenj dhe prishja e shtratit të lumit- Insp. Komunal.....	136
Figura 67 Dëmtimi i arave përreth nga shfrytëzimi i rërave në toka punuese- Insp. Komunal.....	137
Figura 68 Ri kultivimi-mbushja me bërlllok i gropave te shfrytëzuara -kontaminimi i tokës me mbetje urbane – Insp. Komunal.....	138
Figura 69 Krijimi i pellgjeve me ujë si pasoj e shfrytëzimit të rërave	139
Figura 70 Shfrytëzimi i inerteve në lum, dëmtimi i shtresës dyshemore të shtratit të lumit - Insp. Komunal.....	140
Figura 71 Krijimi i deponisë me grumbull uji dhe dëmtim i kufirit të arave përreth – Insp. Komunal	141
Figura 72 Deponi uji nga shfrytëzimi i argjilave dhe rërave, pellgje degraduese dhe rrezik për njerëz – Insp. Komunal.....	142
Figura 73 Shfrytëzimi i qymyreve i cili bëhet pa kriter duke dëmtuar ambientin, shkaktim i rrezikut dhe dëmtim i pronave përreth vend-shfrytëzimit – Inspk. komunal.....	144
Figura 74 Shfrytëzimi pa kriter, krijim lartësisë së shkallëve dhe mungesa e ri-kultivimi- Insp. Komunal.....	144
Figura 75. Shfrytëzimin operatori ilegal nuk ka arritur ta bëjë shfrytëzimin në thellësi por vetëm shtresë që e ka lejuar makineria. Degradim i terrenit dhe prishje ambientit – Insp. Komunal.....	146
Figura 76 Dëmtim i ambientit dhe rrezikim i shkallëve përfundimtare si shfrytëzim pa kriter- Insp. Komunal.....	147
Figura 77 Aktiviteti i një seperim ilegal dhe marrja e resursit (rërës) në mënyrë ilegale- Inp. Komunal.....	148
Figura 78 Aktiviteti ilegal i bazës së betonit dhe shfrytëzimi i resursit të përpunuar nga seperacionet- Insp. Komunal	150
Figura 79 Degradimi ambientit nga pluhuri -Insp. Komunal.....	152
Figura 80 Degradimi i ndodhur në vazhdimësi dhe gjendja faktike e ndotur mjedisore përreth impiantit - Insp. Komunal.....	153
Figura 82 Formular Kontrolli.....	158

HYRJE

Ky doracak do shërbej si njohje e informacionit lidhur me aktivitetet minerar dhe aktivitete tjera bizneseve lidhur me ushtrimin e aktiviteteve të tyre dhe efektet mjedisore.

Aktivitet minerare ushtrojnë veprimtarin e tyre në funksion të ushtrimit të bizneseve të tyre në përputhje me legjislacionet në fuqi. Legjislacionet aktuale të ushtrimit të aktiviteteve minerare janë të specifikuar si për nga mënyra e licencimi, pajisjeve me pëlqime relevante dhe leje.

Pasi që këto aktivitete gjatë aplikimit të pajisjes me licenca dhe leje ju nënshtrohen disa procedurave të cilat në mënyrë të detajuar i ka shpjeguar ky dokument duke përfshirë institucionet gjegjëse sikurse:

- KPMM- Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve.
- MMPH- Ministria e Planifikimit Hapësinor në disa raste
- Agjencia e Pyjeve të Kosovës dhe
- Niveli i pushtetit lokal- Komunat.

Shpeshherë këto aktivitete bëhen në mënyrë të jashtëligjshme që në terminologjinë vendore quhen si operime ilegale. Këto operime ilegale nga personat fizik dhe juridik kanë për qellim keqpërdorimin e resursit mineral duke përjashtuar metodat e shfrytëzimit me standarde minerare te cilat për pasoj kanë rezultuar me dëme ekonomike për vendin dhe duke shkaktuar zona potencialisht me rrezik të lartë për njerëz dhe mjedisin ne veçanti.

Në disa raste përveç operimeve ilegale keqpërdorime bëjnë edhe operatorët e licencuar gjatë ushtrimit të drejtës së licencës duke shkaktuar degradime mjedisore si pasoj e mos respektimit të rregullave të vendosura nga kushte e vendosura në pëlqime apo leje. Për këtë arsye është planifikuar që ky udhëzues të jetë si përshkrues i aktiviteteve të tilla dhe masat që duhet ndërmarr në këto raste nga institucionet.

DISPOZITA LIGJORE – LIDHUR ME PARANDALIMIN E DEGRADIMIT MJEDISOR

Legjislacioni në fuqi

- Kushtetuta e Kosovës 2008
- Ligji për Gjykatat (Nr. 03/L-199)
- Kodi i Procedurës Penale
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Nr. 04/L-082)
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 03/L-025)
- Ligji për Policinë (Nr. 04/L-076)
- Ligji për Avokatin e Popullit (Nr. 03/L – 195)
- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 Shtator 2010),
- Ligji Nr.04/L-060 për Mbeturinat (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 24 Maj 2012),
- Ligji Nr. 03/L-015 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 12 Shkurt 2009),
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma (17 Mars 2008),
- Ligji Nr. 03/L-024 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (26 Shkurt 2009),
- Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit (i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 25 Shkurt 2010),
- Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26 Mars 2009),
- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 Mars 2013),
- Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 31 Maj 2012).
- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 Gusht 2010)
- Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Minierat dhe Mineralet (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 02 Maj 2013)

Përveç legjislacionit primar në Kosovë, legjislacioni sekondar në fushën e të drejtës së mjedisit në mënyrë tipike është lëshuar me autorizim të qartë nga një dispozitë ligjore për zbatimin e dispozitave të ligjit. Legjislacioni sekondar përbëhet nga:

- Vendimet - të cilat janë marrë nga autoriteti kompetent dhe në kuadër të autorizimeve të dhëna me ligj duke vendosur për emërimet, propozimet apo shkarkimet, si dhe për çështjet e tjera administrative që kërkojnë një vendim nga një autoritet përkatës;
- Rregulloret – e lëshuara në bazë të autoritetit të dhënë me ligjin e caktuar dhe në përputhje me qëllimin dhe objektivat e ligjit përkatës, si dhe me vështirimin për rregullimin e çështjeve me të cilat ligji merret në detaje;
- Udhëzimet Administrative – janë akte nënligjore që rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me një fushë të kufizuar të veprimit

KPMM

Çka quajm aktivitet mineralar?

Kush i lëshon këto

licenca dhe leje?



Kush i inspekton këto
licenca dhe leje?

Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet

Hulumtimi	Metoda për ta zbuluar mineralin
Shfrytëzimi	Janë metoda të shfrytëzimit të cilat janë zbuluar më herët
Aktivitete veçanta	Përfshihen metodat e përpunimit, pasurimit të mineralit dhe prodhimit të produkteve nga mineralet

KPMM-ja sipas Ligjit për Minierat dhe Minerlet nr.03/L-163 dhe plotësim ndryshimi L. me nr.04/L-158

Licencat e hulumtimit për dy vite me mundësi vazhdimi

Licencat e shfrytëzimit nga 1 deri në 25 vite

*Lejet për aktivitete të veçanta me vendim Bordit të KPMM-së.
Aktualisht pesë vite*

Sipas Ligjit me nr. 03/L-163 dhe plotësim ndryshimit Ligjit nr.04/L-158

KPMM shqyrton aplikacionet për leje dhe licenca

Inspektorati i minierave të KPMM-së inspekton aktivitetet minerare

Inspektorati i minierave kontrollon edhe aktivitete e jashtëligjshme të resursit mineral

KLASIFIKIMI I OPERIMEVE LEGALE MINIERARE- KPMM

Konsiderohen të gjitha ato veprimtari minerare si (hulumtimi, shfrytëzimi apo aktivitet e veçanta) me t ë cilën ndërmarrjet zhvillojnë aktivitetin e vetë në përputhje me licencat dhe lejet.

Çka nënkuptohet hulumtim, shfrytëzim dhe aktivitet i veçantë?

Aktivitet i hulumtimit nënkuptohet aktiviteti hulumtues i një ndërmarrje për nevoja të hulumtimit të mineralit në licencën e hulumtimit. Aktivitetet hulumtuese të një ndërmarrje mundën të bëhen me:

- Shpime të thella hulumtuese e cila bëhet me makineri hulumtuese figura 1.
- Me metoda gjeofizike figura 2 dhe
- Kanale hulumtuese figura 3



Figura 1 Makina e shpuarjeve të thella -KPMM



Figura 2 Metoda e hulumtimit gjeofizike - KPMM



Figura 3 Metoda e hulumtimit me kanale hulumtuese - KPMM

Aktiviteti i shfrytëzimit, nënkuptohet aktiviteti mineralar i cili ka qëllim shfrytëzimin e mineralit të hulumtuar dhe të identifikuar shkencërisht më herët nga aktiviteti mineralar hulumtues. Sipas sistemeve të shfrytëzimit në parim dallojmë dy metoda të sistemit të shfrytëzimit dhe ato:

- Metoda e shfrytëzimit sipërfaqësor dhe
- Metoda e shfrytëzimit nëntokësor

Aktiviteti i veçantë nënkuptohet përpunimi i mineralit për përfitime të produkteve finalizuese, përpunuese dhe pasuruese dhe objekte të cilat janë të ndërtuara në pozicione fikse –statike dhe ato janë:

- Impiantet e seperimit të rërës dhe gurit të fortë (Sepercionet) figura 4
- Impiantet e përpunimit të betonit (Bazave të betonit) figura 5
- Impiantet e përpunimit të produktit-asfalt (Bazave të asfaltit) figura 6 dhe
- Impiantet e pasurimit të mineralit (Flotacionet) figura 7



Figura 4 Gurëthyesi me seperacion - KPM



Figura 5 Impianti i Betonit- KPM



Figura 6 Impianti për përgatitjen e Asfaltit - KPM



Figura 7 Impianti i pasurimit të mineraleve- Flotacioni - KPM

Cka nënkupthet licencë dhe leje e aktiviteteve të veçanta?

Licenca nënkupthet licenca për hulumtim dhe licenca për shfrytëzim, ndërsa lejet lëshohen vetëm tek aktivitet e veçanta.

Sa është afati i këtyre licencave dhe lejeve?

Licencat e hulumtimit kanë afat 2 deri 3 vjet me mundësi vazhdim edhe një herë. Sipërfaqja e tyre është e kufizuar deri në 100 km² për licencat metalore ndërsa për industriale deri në 10 km².

Licencat e shfrytëzimit përcaktohen nga rezervat e shfrytëzueshme minerale në raport me prodhimtarinë e vjetore por jo edhe më shumë se 25 vite.

Lejet e aktiviteteve të veçanta është e rregulluar sipas Udhëzimit Administrativ. Këto leje kanë afat të përcaktuar nga Bordi i KPM-së, si organ vendim-marrës dhe tani këto leje jepen me afat prej 5 vite me mundësi vazhdimi.

Si duken këto licenca dhe leje të lëshuara nga KPM-ja?

Një operator-ndërmarrje e cila punon në një zonë të caktuar duhet ta ketë në zyre e tij licencën e vetë të lëshuar nga KPM-ja dhe në rast se kërkohet nga një person zyrtar ai duhet ti ja tregoj licencën.

LICENCAT E HULUMTIMIT-KPMM

Licenca është e punuar në letër në formatin A4 me dizajn siç është e paraqitur në figurën 8. Ka kopertina me ngjyrë të verdhë dhe e punuar në material gjysmë të fortë letre e pa plastifikuar.

Një licencë përmbajnë këto karakteristika:

- Emërtimi i licencës
- Emërtimi i Biznesit
- Nr. Regjistrimit biznesit
- Nr. regjistrimit nga KPMM-ja
- Pronari i biznesit
- Kohëzgjatja e licencës dhe sipërfaqja e ushtrimit të veprimtarisë dhe
- Skica me koordinata të kufirit të licencës.

Ky dokument është valide nëse ka vulën e KPMM-së poshtë me nënshkrim të drejtorit, numrin e protokollit dhe datën e lëshimit të licencës.

[illegible]

Figura 8 Forma e një licence të hulumtimit - KPMM

LICENCAT E SHFRYTËZIMIT- KPMM

Licenca është e punuar në letër në formatin A4 me dizajn siç është e paraqitur në figurën 9. Ka kopertina me ngjyrë të verdhë dhe e punuar në material gjysmë të fortë letre e pa plastifikuar.

Një licencë do të përmbajë këto karakteristika:

- Emërtimi i licencës
- Emërtimi i Biznesit
- Nr. Regjistrimit biznesit
- Nr. regjistrimit nga KPMM-ja
- Pronari i biznesit
- Kohëzgjatja e licencës dhe sipërfaqja e ushtrimit të veprimtarisë dhe
- Skica me koordinata të kufirit të licencës.

Ky dokument është valid nëse ka vulën e KPMM-se poshtë me nënshkrim të drejtorit, numrin e protokollit dhe datën e lëshimit të licencës.

The image shows a sample of a Mining License (Licence Shfrytëzimi Rudarska) issued by the Republic of Kosovo. The license is titled "LICENCE SHFRYTËZIMI RUDARSKA / MINING LICENSE" and is numbered "XXXXXX". It is issued to the "Komiteti i Përbashkët për Mbrojtjen dhe Mbrojtjen e Mbrojtjes" (Joint Committee for Protection and Defense). The license is valid for a period of 10 years, starting from the date of issuance. The license area is defined by a map showing the location of the mine. The license is signed by the Director of the KPMM (Director of the Mining and Mineral Resources Administration) and includes the date of issuance.

Annotations pointing to the license features:

- Emërtimi i licencës. Nr. Licencës
- Të dhëna nga kompania
- Kohëzgjatja e licencës dhe sipërfaqja
- Lokacioni i licencës
- Nënshkrimi i drejtorit KPMM-së
- Nr. prot. Data e lëshuarjes së licencës

Figura 9 Forma e një licence të shfrytëzimit - KPMM

LEJET E AKTIVITETVE TË VEÇANTA- KPMM

Leja është e punuar në letër në formatin A4 me dizajn siç është e paraqitur në figurën 10. Ka kopertina me ngjyrë të verdh dhe e punuar në material gjysmë të fortë letre e pa plastifikuar.

Një leje do të përmbaj këto karakteristika:

- Emërtimi i lejes
- Emërtimi i Biznesit
- Nr. Regjistrimit biznesit
- Nr. regjistrimit nga KPMM-ja
- Pronari i biznesit
- Kohëzgjatja e lejes dhe sipërfaqja e ushtrimit të veprimtarisë dhe
- Skica me koordinata të kufirit të licencës.

Ky dokument është valid nëse ka vulën e KPMM-se poshtë me nënshkrim të drejtorit, numrin e protokollit dhe datën e lëshimit të licencës.

[illegible]

Figura 10 Forma e një leje të aktiviteteve të veçanta- KPMM

A posedojnë të gjithë operatorët e licencuar këtë formë standarde apo mund të kenë edhe ndonjë formë tjetër të licencës?

Po, mund të kenë edhe forma të vjetra sepse forma e tillë e prezantuar si më lartë janë model i ri i licencës në një faqe. Format e vjetra e kanë këtë dizajn dhe mund të janë valide si në figurën 11. Kjo formë është pothuajse e njëjtë edhe për rastet e lejeve të aktiviteteve të veçanta dhe shumë rralla për licenca të hulumtimit sepse për shkak të jetë-gjatësisë së shkurtër kanë mundësi të gjasave të jenë me pak ose fare mos të kanë këtë formë të këtyre licencave apo lejeve.

The diagram illustrates the structure of a mining license form, divided into two main sections: the front page (left) and the back page (right). Red arrows point from labels in green boxes to specific sections of the form.

Labels (Green Boxes):

- Data e lëshuarjes së licencës
- Nr. i licencës
- Lloji i mineralit
- Të dhënat bazike të personit juridik
- Afati i licencës
- Nënshkrimi nga drejtori dhe personi i pajisur me licencë

Form Sections:

Front Page (Left):

- Logos: European Union, UNMIK, Independent Commission for Mines and Minerals, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale.
- Date: Prishtinë, xx.xx.20xx
- Title: LICENCE PER SHFRYTËZIM Nr. xx/ICMM/0x Per Specifikohet shkëmbi
- AUTORITETI: Bordi Qeverisës i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale më 05.12.2006 ka aprovuar këtë Licencë për Shfrytëzim në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/2, neni 2 dhe 6, dhe Rregullores së UNMIK-ut 2005/3, nenet 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35, të shpallura më datën 21 Janar 2005.
- PERSONI I PAJISUR ME LICENCË:
 - Emri i Biznesit : "xxx"sh.p.k.
 - Emri : Emri Mbiemri bartës i licencës
 - Adresa : Vendi: Komuna
 - Nr. i Regjistrimit të Biznesit : Nr. identifikues personal biznesit
- MINERALET E LICENSUARA PËR SHFRYTËZIM: Shkëmb të fort ose tjetër
- Personi i pajisur me Licencë me këtë rast është i autorizuar që të shfrytëzojë mineralet e shkëmbit të fort brenda Zonës së Licencës.
- ZONA E LICENCËS:
 - Zona e Licencës përfshin një sipërfaqe prej (shënuar me numër sipërfaqja) m². Sipërfaqja është një poligon, e përcaktuar me koordinatë në tabelën e bashkëngjitur (Shtojca S), dhe përfshin ngjarjet kadastrale të renditura në tabelën e bashkëngjitur (Shtojca R).
- AFATI:
 - Afati i kësaj Licence është xx vite, nga xx.xx.2000 deri më xx.xx.20xx.
- KUSHTET:
 - Kjo Licence lëshohet duke iu nënshtruar kushteve standarde të parastruara në Rregulloren e UNMIK-ut 2005/3, Neni 35 dhe të gjitha kushteve të tjera të cilat janë përcaktuar me postë.
 - Personi i pajisur me Licencë kërkohet që të përmbajet kushteve si më poshtë:
- Contact info: Tel: +381 (0) 240 232, Fax: +381 (0) 240 344, Mobile: +381 (0) 240 232, Email: E-mail: icmm@unmik.org, Web: www.icmm.org
- UNMIK logo

Back Page (Right):

- DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA JANË PJESË E LICENCËS:
 - Shtojca A: Kërkesa
 - Shtojca B: Vërtetimi i lëshuar nga Policia mbi mos përfshijë në hetim
 - Shtojca C: Deklarata e Paraqitësit të Kërkësës mbi Përshtatshmërinë
 - Shtojca D: CV e Personit Përfshijës
 - Shtojca E: Formulimi i Personit Përfshijës
 - Shtojca F: Kualifikim(et) e vërtetuar - Diploma
 - Shtojca G: Certifikata e Plotë e Regjistrimit të Biznesit
 - Shtojca H: Pëlqimi komunal
 - Shtojca I: Marrëveshje(t) mbi të Drejtat në Sipërfaqe nëse është e aplikueshme
 - Shtojca J: Hartë e cilat paraqet fushën për të cilën paraqitet kërkesa, duke përfshirë koordinatat në Kosovare/01 dhe Hollësitë
 - Shtojca K: Kopja e Planit(ëve) të Fushës për të cilën paraqitet kërkesa
 - Shtojca L: Lista(t) e Përdhuesve të Kopjeve të Planeve
 - Shtojca M: Koordinatat në Kosovare/01
- Date: xx.xx.200x.
- Signature: Xx xxx, Drejtor, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
- Nënshkrimi i autorizuar
- Date: xx.xx.200x
- Personi i pajisur me Licencë
- Page 5 nga 5

Figura 11 Modeli i vjetër i licencave dhe lejeve faqja e parë dhe faqja e fundit e licencës së modelit të vjetër- KPMM

Si ushtron veprimtarinë një ndërmarrje me licencë shfrytëzimi të lëshuar nga KPMM-ja?

Secila ndërmarrje që ka kryer punët gjeologjike hulumtuese dhe ka vërtetuar se një vlerësim ekonomik i shfrytëzimit të resursit është profitabil për ndërmarrjen atëherë ndërmarrësi aplikon në KPMM për licencë shfrytëzimi. Aplikimi në KPMM për licencë shfrytëzimi është kusht ligjor që të plotësoj dokumentacionin e kërkuar, ku përveç tjerash edhe si dokument bazik është edhe projekti i shfrytëzimit me të cilën planifikon ta shfrytëzoj mineralin në përputhje me projektin e aprovuar paraprakisht para marrjes së licencës.

Se si zhvillohet miniera sipërfaqësore në etapat e saja do shpjegohet me shembuj praktik si në vijim gjatë zhvillimit të minierës nga hapja deri në mbylljen e saj:

- a) Miniera përgatit zonën për zhvillim aktiviteti minerar duke ndërtuar infrastrukturën përcjellëse dhe largimin e shtresës topografike - së korës të terrenit dhe fillimi i ngarkimit figura 12 .



Figura 12 Largimi i mbulesës si fazë përgatitore e fillimit të punëve minerare- KPMM

Ky aktivitet është në përputhje me projektin dhe kompania duhet ta ketë licencën e shfrytëzimit të lëshuar nga KPMM.

- b) Nëse aktiviteti i minierës është me minim atëherë duhet të zhvillohet sistemi i përgatitjes së fushës për minim siç njihet tek KPMM-ja si para-minimi dhe përgatitja për minim figura 13, 14



Figura 13 Aktiviteti i përgatitjes së fushës për minim - KPMM.



Figura 14 Aktiviteti minerar përgatitja e fushës për minim - KPMM

Ky aktivitet është në përputhje me projektin dhe ndërmarrësi duhet ta ketë licencën e shfrytëzimit të lëshuar nga KPMM me aktivitet minerar me minim dhe i lejohet përdorimi i eksplozivit por duhet ta ketë edhe lejen e përdorimit të eksplozivit në ditën kur përdor eksplozivin. Nëse ndërmarrësi nuk ka leje për minim atë ditë atëherë konsiderohet si aktivitet i jashtëligjshëm minerar.

- c) Fillimi i ndërtimit të etazheve (shkallëve punuese) figura 13 dhe 15 dhe



Figura 15 Fillimi i ndërtimit një shkalle punuese minerare - KPMM

Është kushti i krijimi të shkallëve punuese dhe përfundimtare të minierës. Shkallët punuese janë me dimensione të sheshit punues¹ me të mëdha ndërsa në shkallet në përfundim mund të jenë më të vogla. Këto punë minerare kontrollohen nga KPMM-ja.

d) Krijimi i etazheve përfundimtare dhe përgatitja për mbylljen e minierës figura 16



¹ Sheshi punues – gjerësia e hapësirës ku mund të lëvizet lirshëm ndërmjet dy niveleve të shkallëve

Figura 16 Shkallët përfundimtare - KPMM

e) Shkallët përfundimtare dhe ri-kultivimi i minierës figura 17 (1 dhe 2).

Ky proces është i njohur si aktivitet i para final të një miniere të ndërtuara mirë shkallët përfundimtare.



Figura 17 Ri-kultivimi i shkallëve të minierës me ri-kultivim - KPMM

Të spjegohen edhe disa kritere për tu pajisur me licenca të shfrytëzimit dhe lejeve të aktiviteve të veçanta?

1. Para se të aplikoj një kompani për licencë shfrytëzimi ajo paraprakisht duhet të sigurohet se ka aplikuar në zonën ku ka kryer hulumtimet sipas licencës së hulumtimit.
2. Kompania, mund të aplikoj për çfarëdo sipërfaqe aplikuese për licencë por duhet të jetë në harmoni me sipërfaqen edhe pëlqimet paraprake sikurse:
 - 2.1 Pëlqimi, ekstrakti apo njoftimi nga komuna se nuk bie ndesh mbi planin urbanistik dhe urban
 - 2.2 Pëlqimin nga pronari (pronar mund të jetë: komuna, APK-ja, AKP-ja apo prona private)
 - 2.3 Pëlqimi mjedisor nga MMPH-ja.
3. Projektet, dokumentacioni i kërkuar dhe
4. Shqyrtimi i aplikacionit bëhet në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Çka nënkuptoni me pëlqime dhe a mund të jepet ndonjë licencë apo leje pa pëlqime?

Pëlqimet janë akte juridike të cilat miratojnë kërkesën e aplikantit për tu pajisur me pëlqim. KPMM-ja i pranon këto pëlqime dhe ato sipas përshkrimit në pëlqim. Duhet sqaruar se pa pëlqimet relevante aplikanti nuk mundet për tu pajisur me licencë shfrytëzimi apo leje të aktiviteteve të veçanta. Duhet sqaruar se KPMM e ka të drejtën e diskrecionit por një veprim të tillë asnjëherë deri me tani nuk është praktikuar, d.m.th respektohet kriteri se pa pëlqime të lartë cekura nuk pajisen me licenca apo leje.

Nga përshkrimi i mëhershëm është shpjeguar edhe Shqyrtimi i aplikacionit në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Përshkruaj pak me detaje disa elemente bazike të cilat duhet ti plotësoj kompania?


Shqyrtimi i aplikacionit në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale sipas:

1. Ligjit për miniera dhe Minerale nr. 03/L-163 dhe plotësim ndryshim i tij Nr.04/L-158.
2. Pjesa 1 e këtij ligji neni 3 specifikon licencat dhe lejet sipas përkufizimeve dhe neni 13 aktivitete e kufizuara.


Çka nënkuptohet me respektim të nenit 13 “Aktivitetet e kufizuara”?

Nënkupton të gjitha distancat me të cilat janë të domosdoshme në raport me aplikacionin. Për më detaje do shpjegohet me skema praktike për secilin objekt apo infrastrukturën rrethuese përgjatë aplikacionit për licencë.

Skema. 1: Sqarim i detajuar lidhur me aplikacionet për licenca të shfrytëzimit- Distancat e specifikuar sipas Ligjit për Minierat dhe Mineralet



Rruga Autoudhe 100 m pa minim dhe 500 m me minim.
 Rruga Nacionale, lokale, vendbanimit dhe urbane 60 m pa minim dhe 500 m me minim
 Rruga lidhese 60 m me minim dhe pa minim
 Rruga pa kategorizuar 10 m me minim dhe pa minim



A ka te specifikuar se si duhet rrethuar dhe përdorur sinjalizimi i një miniere?

Udhëzimi administrativ për format e rrethojave dhe sinjalizimeve është draftuar dhe besoj se nga gjysma e tretë e vitit të ardhshëm nga viti i këtij dokumenti do te implementohet në tërësi.

Ku mund ti gjejmë këto udhëzime administrative?

Në gazetën zyrtare, por me shpejt vizitoni veb faqen e KPMM-së. <https://www.kosovo-mining.org/publikime/udhezime-administrative/>

A mund të bëjë përjashtim KPMM-ja lidhur me këto kufizime të nenit 13 “Aktivitetet e kufizuara”?

KPMM-ja, mund të bëjë përjashtime të këtyre kufizimeve vetëm sipas LMM-së dhe ato mund të lejohen sipas paragrafit 2 të këtij neni ku thuhet se aprovimi nga pronari sipas marrëveshjes apo pëlqimit me objektin apo infrastrukturën apo konstatimin nga pëlqimi i lëshuar për aprovim mund të përdoret si kriter lehtësues dhe i aprovuar për përjashtimin e këtyre ndalesave.

A punohet në këto veprimtari edhe nga personat juridik apo fizik pa licencë dhe leje?

Fatkeqësisht ka persona juridik dhe fizik që këtë veprimtari e ushtrojnë jashtëligjshëm dhe në ato zona ku aktiviteti i tyre zhvillohet në sipërfaqe dhe me sistem të shfrytëzimit me gërmim kur minerali është inert apo i brishtë për tu larguar nga topografia e korës së sipërfaqes apo ka depozitime të resursit inert siç janë rërat dhe zhavorret.

Si klasifikohen këto operime të jashtëligjshme- ilegale?

Për ta shpjeguar më mirë klasifikimin e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare do prezantojmë disa shembuj me përshkrim të këtyre aktiviteteve.

KLASIFIKIMI I OPERIMEVE ILEGALE MINIERARE - KPMM

Si konsiderohet një veprimtari e jashtëligjshme ilegale minerare sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale?

Neni 70

Aktivitetet e jashtëligjshme të hulumtimit, shfrytëzimit dhe aktivitetet e veçanta

1. Nëse një inspektor i autorizuar ka arsye të mira për të besuar se një person është duke ushtruar aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta dhe se ky person nuk posedon Licencë ose Leje nga KPMM, inspektori menjëherë e informon Policinë e Kosovës e cila menjëherë dërgon së paku dy zyrtar policor në vendin e ngjarjes.
2. Pas arritjes së zyrtarëve të policisë dhe me ndihmën e tyre, inspektori verifikon identitetin e personave të përfshirë në këto aktivitete dhe konstaton nëse këta persona ose punëdhënësi i tyre, (nëse kanë punëdhënëse), posedojnë Licencë ose Leje nga KPMM.
3. Nëse asnjëri nga këta persona ose punëdhënësi i tyre (nëse kanë punëdhënëse) nuk posedojnë Licencë ose Leje nga KPMM, zyrtarët e policisë e arrestojnë Personat në fjalë të cilëve më pas u shqiptohet gjoja administrative e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 79 të këtij ligji dhe dënimet penale sipas Nenit 80 të këtij ligji. Përveç kësaj, inspektori sekuestron të gjitha mjetet punuese dhe mineralet e nxjerra që gjenden në vendin e rastit.
4. Nëse këta Persona ose punëdhënësi i tyre posedojnë Licencë ose Leje nga KPMM, por aktivitet përkatëse të shfrytëzimit ose hulumtimit nuk janë të autorizuar me atë Licencë ose leje, inspektori menjëherë i raporton këto aktivitete të paautorizuara në KPMM dhe KPMM i shqipton Bartësit të Licencës ose Lejes masat e përcaktuara në Nenin 9 të këtij ligji.

Pas përgatitjes së raporteve nga tereni në lidhje me aktivitetet e jashtëligjshme, kryerjes së matjeve dhe raportit nga Dep. i Financave, atëherë Dep. Ligjor përgatit vendimet për gjobë dhe Kallëzimin penal e dërgon në Prokurorin përkatëse kompetentet.

Sa ju përket licencave të lëshuara nga KPMM-, veprohet në përputhje me nenin 9 të LMM-së në rastet kur nuk iu përmbahet kushteve të licencës apo e humb ndonjërin nga kushtet e licencës – pezullimi apo anulimi i licencës apo lejes për mospërputhshmëri.

Aktivitetet e jashtë ligjshme minerare grupimi i tyre:

1. Aktivitet i jashtëligjshëm në hulumtim.
2. Aktivitet i jashtëligjshëm në shfrytëzim dhe
3. Aktivitet i jashtëligjshëm në aktivitet të veçanta

Baza ligjore dhe struktura organizative e inspektimeve në regjione?

Inspektorati i minierave ndanë përgjegjësitë sipas direktivave të hartuara nga kryeinspektori i minierave.

Sipas shpërndarjeve të përgjegjësiave dhe mbarëvajtjes së punëve inspektuese inspektorati i minierave ka të ndara përgjegjësit si në vijim:

- Inspektor i minierave (xehetar dhe gjeolog) nga një në inspektor në secilin regjion. Gjithsejtë pesë regjione.
- Inspektor i minierave për inspektime të minierave nëntokësore.
- Inspektor i minierave sipërfaqësore KEK, Fero-Nikel, Sharr-Cem.
- Inspektor i minierave për eksplozive.
- Inspektor i minierave makineri dhe elektrikë.
- Në kuadër të kësaj strukture ka edhe një zyrtar për kontroll të kualitetit.

Si identifikohen operatorët gjatë inspektimeve, se a posedojnë licenca dhe leje?

Inspektorati i minierave ka në kontroll të gjithë operatorët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas lejeve dhe licencave. Kjo bëhet nga sistemi i integruar i Gjeo - Data bazës, një Data-bazë e KPMM-së e cila mbanë shënime për secilin operator varësisht prej statusit të tyre që kanë.

Çka nënkuptohet me statusin e operatorit?

Secili operator në Data-Bazën e sipërshënuar përmban shënime lidhur me statusin dhe kjo nënkupton:

- Operatori ka vetëm aplikacion për leje dhe licencë dhe është në fazën e shqyrtimit të saj për tu pajisur me leje apo licencë.
- Operatori ka leje dhe licencë aktive dhe është në fazën e punës së saj dhe ka të saktësuar edhe afatin e lejes dhe licencës.
- Operatori ka statusin e pezulluar të veprimtarisë minerare varësisht nga kërkesa e tij apo ndonjë rrethanë tjetër ku mes tjerash janë edhe: Humbja e validitetit të ndonjë pëlqimi si kriter i licencës apo lejes apo mos përmbushja e detyrimeve nga ana e operatorit, e vendosur nga KPMM-ja.
- Operatori ka licencën apo lejen të anuluar dhe është në fazën e përmbylljes apo ju është mbyllur licenca apo leja.
- Operatori është evidentuar si operator i jashtëligjshëm pa licencë dhe leje dhe evidentohet se sa herë ka ushtruar veprimtarinë e tij ilegale dhe në cilat lokacione.

Si vepron KPMM-ja sipas proceduarve, evidentimin e një operatori ilegal?

Kjo është shpjeguar si më lartë në kuadër të këtij kapitulli shpjegues respektivisht sipas LMM-së (Ligji për Miniera dhe Minerale) neni 70. Mirëpo për ta bërë sa më funksionale dhe të dokumentuar një kallëzim penal KPMM-ja ka një dokument të emërtuar si “Qarkore” e cila e bënë të përgjegjshëm dhe obligues secilin departament të KPMM-së për të përpiluar proceduralisht raportet e tyre deri në finalizim të një kallëzimi penal të kompletuar për prokurori.

Si funksionin kjo qarkore dhe si zhvillohen procedurat e mbarëvajtjes për një kallëzim penal?

Qarkorja është e qasshme për KPMM-në dhe funksionon nga këto departamente:

1. INSPEKTORATI-Raporti i Inspektorit të minierave – Raport për Aktivitete të jashtëligjshme minerare.
2. ZYRA E REGJISTRIMIT- Arkiva elektronike dhe fizike.
3. GJEODEZIA-Raporti nga dep. Gjeodezisë .
4. FINANCAT-Raporti nga dep. Financave.
5. ZYRA LIGJORE-Vendimi lidhur me gjobën dhe kallëzimi penal.
6. GJEOLOGJIA-Raporti i Gjeologjisë dhe GIS.
7. KOMISIONI SHQYRTUES I ANKESAVE.
8. BORDI I KPMM-së.

Hapi i parë - Raporti i Inspektorit të minierave – Raport për Aktivitete të jashtëligjshme minerare.

- Inspektori i minierave i regjionit apo inspektor të tjerë të KPMM-se së pari evidentojnë operatorin e atakuar në një veprimtari minerare ku lënda minerale ka qëllim për komercializim (d.m.th operatori përfiton materialisht nga masa e gërmuar dhe konsiderohet si masë e minerale "jo tatimore").
- Inspektori merr shënime bazike për të punuar një raport terreni. Shënimet bazike që duhet kërkuar për ta plotësuar një raport terrenit nga inspektori i minierave duhet përfshijnë:
 - Të dhënat e operatorit,
 - Shënime lidhur me lokacionin,
 - Shënime lidhur me llojin e mineralin të shfrytëzuar,
 - Shënime mbi makinerinë me të cilën është duke punuar,
 - Shënime me koordinata të terrenit ku është kryer gërmimi,
 - Shënime tjera shtesë sipas nevojës.

Inspektori pasi ti ketë marrë këto shënime lëshon një dokument operatorit të atakuar "Urdhëresë për ndalim të aktiviteti të jashtëligjshëm"-.

- Inspektori me të lëshuar këtë urdhëresën me shënimet e marra nga terreni më pastaj në KPMM verifikon zonën në Gjeo-Databazë për lokacionin në fjalë dhe përpilon raportin e emërtuar "Raport për Aktivitete të jashtëligjshme minerare" dhe nëse ka arsye për të rekomanduar matje gjeodezike obligon dep. Gjeodezisë që të bëjë matje gjeodezike.
- Këtu përfundon raporti i Inspektorit për të ju hapur rrugë dep. tjera të KPMM-së për ta proceduar qarkoren sipas pikës 2 .

Hapi i dytë - Raporti nga Z. Regjistrimit Arkiva elektronike dhe fizike

- Nga titullari i raportit të dorëzuar për arkivim menjëherë krijohet një folder elektronik me emërtim të kompanisë apo personit fizik dhe aty ruhet ky raport si i skanuar dhe i protokolluar. Skanohet raporti fillestar nga inspektori për të vazhduar edhe raportet tjera sipas shpjegimit si me lartë si dhe raportet tjera sipas kësaj qarkore të shpjeguar.

Hapi i tretë - Raporti nga dep. Gjeodezisë

- Nga raporti i inspektoratit nëse merr rekomandim se duhet bërë matje gjeodezike së bashku me njërin nga inspektorët e minierave të cilët kanë përpiluar raportin. Matja nuk guxon të kryhet me vonë se tri ditë pune përjashtimisht në rrethana të jashtëzakonshme mund të shtyhet nëse dep. Gjeodezisë ka obligime tjera që nuk mund ta përmbushë këtë afat. Raste të tilla të vonesave të matjeve janë shumë të pakta ose pothuajse nuk ka.
- Pasi të bëhet matja dhe krahasimi i vëllimeve para gërmimeve dhe hapësirës së shfrytëzuar ky departament përpilon një raport të titulluar: “Raporti mbi kalkulimin e vëllimit”, masën vëllimore të nxjerr nga kjo zona (gropa) ku është hasur operatori.
- Ky raport vendoset i protokolluar dhe i skanuar në folderin nëpërmjet arkives sipas shpjegimit nga “hapi i dytë”
- Këtu përfundon raporti i dep. Gjeodezisë për të ju hapur rrugë departamenteve tjera të KPMM-së për ta proceduar renditjen sipas qarkores nga pika katër .

Hapi i katërt - Raporti nga dep. Financave

- Pasi të jetë punuar raporti nga dep. Gjeodezisë, zyra e regjistrimit përcjell sipas titullarit të raportit gjendjen e raportit tek dep. Financave dhe së bashku me shënimet lidhur me llojin e resursit se në cilën kategori të rentës minerale i takon atëherë ngarkon operatorin me dy gjopa njëren në vlerën prej 5,000 € dhe tjetrën sipas trefshit të rentës minerale për atë resurs mineral duke shumëzuar me vëllimin e matur.
- Departamenti i financave nga raporti i protokolluar në formë tabelave jep pasqyrën e dëmit të shkaktuar në vlerën monetare.
- Këtu përfundon raporti i dep. Financave për të ju hapur rrugë departamenteve tjera të KPMM-së për ta proceduar qarkoren sipas pikës 5 .

Hapi i pestë – Vendimi për gjobë dhe kallëzimi penal

- Zyra Ligjore pasi të ketë marrë këto shënime nga dep. Financave nga zyra e regjistrimit kuptohet se janë plotësuar kushtet sipas qarkores dhe përpilon dy shkresa:
 - Aktvendimin lidhur me gjobën duke përfshirë elementet bazike nga raportet e shpjeguara sipas qarkores dhe
 - Kallëzimin penal
- Këto dy dokumente ruhen të protokolluar dhe skanuara në folderin nga arkiva sipas shpjegimit nga “hapi i dytë”

Hapi i gjashtë – Raporti i gjeologjisë dhe GIS.

- Gjeologjia me të pranuar aktvendimin nga arkiva sipas shpjegimit të “hapi të dytë” e futë në Gjeo-Databaz shënimet dhe lokacionin se ku është hasur operimi ilegal.
- Këtu përfundon evidentimi i të dhënave të operatorit me lokacionin dhe sasinë dhe llojin e resursit mineral .

Hapi i shtatë – Raporti i KSHA-së

- Pasi që kompania ta ketë pranuar aktvendimin për gjobë, atëherë rrjedhë afati ligjor për të drejtën e ankesës.
- Ankesa skanohet dhe ruhet e protokolluar dhe skanuar në folderin nga arkiva sipas shpjegimit të “hapi të dytë”

- Nëse kompania bënë ankesë për aktvendimin, atëherë KSHA² (komisioni shqyrtuesi ankesave) e shqyrton ankesën me prova të sjella nga ankuesi dhe gjendjen e krijuar nga qarkorja dhe jep rekomandime për bordin e KPMM-së.

Hapi i tetë – Vendimet e Bordit të KPMM-së

- Bordi i KPMM-së analizon rekomandimet dhe ka të drejtë aprovimi, rikthimi në shqyrtim, refuzimi të rekomandimeve të KSHA-së.
- Pas këtij vendim të drejtë ankese pala e pakënaqur ka vetëm në Gjykatën Themelore, Departamenti për çështje administrative.
- Aktvendimi skanohet dhe ruhet i protokolluar dhe skanuar në folderin nga arkiva sipas shpjegimit të “hapit të dytë”.

Nëse KPMM e ka të rregulluar mirë shqiptimin e kallëzimit penal atëherë, a shqiptohen edhe dënime mandatore dhe kundërvajtës?

Ligji për Minierat dhe Mineralet është Ligj i veçantë dhe procedurat e shkeljeve apo keqpërdorimit të resursit i ka të rregulluara dhe të kategorizuara si vepër penale, ndërsa për kundërvajtje nuk e parasheh ligji.

Përveç kallëzimeve për veprën penale vjedhje të resursit, KPMM ka dënime edhe administrative dhe mandatore.

Pasi që ky dokument e parasheh vetëm mbrojtjen e mjedisit atëherë do shpjegohen vetëm disa nene të dënimeve mandatore të cilat mund ti shqiptoj KPMM-ja në rastet e degradimeve mjedisore nga aktivitet minerare tek operatorët juridik të licencuar.

DËNIMET ADMINISTRATIVE.

- DA013- Në qoftë se personi juridik pas ndërprerjes së përkohshme të punëve kërkimore ose shfrytëzuese, nuk i aplikon masat e duhura të sigurisë me të cilat do të përjashtohet mundësia e paraqitjes së rrezikut për njerëz, shtazë dhe pasuri..... Masa e shqiptimit të gjobës 5,000 €
- DA014 - Në qoftë se personi juridik nuk e rehabiliton dhe ri-kultivon tokën e dëmtuar nga aktivitetet hulumtuese, përpunuese dhe minerare..... Masa e shqiptimit të gjobës 10,000 €
- DA019-Në qoftë se personi juridik nuk i zbaton masat për mbrojtjen e ambientit.
..... Masa e shqiptimit të gjobës 10,000 €

² KSHA-Komisioni shqyrtuesi i ankesave i përbërë nga pesë anëtar profesional të brendshëm të KPMM-së

AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË HULUMTIM - KPMM

Kuptohen të gjitha ato aktivitete që kryhen nga personat fizik apo juridik të cilët bëjnë aktivitete hulumtuese si:

- a) Pa licencë hulumtimi
- b) Në licencë të skaduar, mbyllura apo të pezulluar dhe
- c) Jashtë zonës së licencës së paraparë në kushte të vendosura të licencës.

Këso raste me aktivitet te jashtëligjshme hulumtuese nuk janë evidentuar ndokund.

Specifike e këtyre hulumtimeve është se ka raste kur institucionet tjera (APK) të cilat në një formë janë pronar të ngastrave ku ndërmarrjet dëshirojnë të bëjnë hulumtim dhe që nuk marrin aprovim nga pronari dhe ka mos pajtueshmëri se pa pëlqim pronarit nuk mund të zhvillohet hulumtimi. KPMM me ligj nuk e ka të rregulluar këtë sepse zonat për licenca hulumtim janë me sipërfaqe të mëdha dhe me numra të shumtë të ngastrave të cilat bëjnë hulumtime dhe kjo çështje e hulumtimit është e rregulluar në mes të ndërmarrësit dhe pronarit të parcelës ku bëhet hulumtimi.

Aktivitetet hulumtuese nuk mund të shkaktojnë degradime të mëdha për ambientin vetëm në disa raste minore si hulumtim me kanale dhe që kanë interes për një resurs mineral metalor, këto raste janë shumë të vogla.

AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË SHFRYTËZIM- KPMM

Këto aktivitete janë më të theksuara dhe kanë të bëjnë me aktivitet komerciale të resursit pa posedim të licencës nga personat juridik.

Aktivitet i jashtëligjshëm në shfrytëzim konsiderohet në këto raste:

Kur takohet personi fizik apo juridik me të cilën nuk prezanton para inspektoratit te minierave licencën e shfrytëzimit.

Kur ka aktivitet minierar eskavim-ngarkim- transport të masës së mihur me nevoja komercializimi (konstatim i komercializimit të masës së mihur)

Kur kjo masë e mihur sipas pikës (c) nuk deponohet në ndonjë lokacion me të cilën ka pëlqim nga pronari si për mihje ashtu edhe për mbushje të masës së mihur por që nuk i dihet vend-deponimi apo deponimi nuk shkakton rrezik për ambientin në raport me vëllimin e deponuar.

Komercializim i masës së minuar ku kërkesën për minim special e ka të ri destinuar për diçka tjetër si: hapje rrugësh, sanim gjendjes së krijimit të niveleve të ndryshme dhe se masën e tillë e komercializon (KPMM nuk mund ta tatimoj masën e tillë të minuar si rentë minerare pa nr. Licence)

AKTIVITETET ILEGALE ME PASOJA DEGRADUESE AMBIENTALE DHE SHKAKTIMI I RREZIKUT -KPM

Pasoja e një aktiviteti ilegal në shfrytëzim manifestohet gjithëherë me shkaktimin e degradimit ambientit dhe rrezikut për njerëz si dhe kafshë. Sipas vendburimeve minerale edhe dallojmë aktivitet e jashtëligjshme sikurse :

Vendburimet Inerte (rërë dhe zhavorr)

- Përgjatë lumenjve kemi degradim të shtratit të lumenjve, prishjes së kadastrit të lumenjve dhe zhvendosje të lumit në zonat ku kemi dëmtim të pronës dhe rrezikut nga humbja e ujërave sipërfaqësore në tentativa të drenazhimit në ujëra nëntokësor si pasoj e dëmtimit të shtresës së dyshemesë së shtratit të lumit. (Figura18 foto 1,2,3,4)







Figura 18 Shfrytëzimi ilegal në lumenj dhe prishja e shtratit të lumit - KPMM

Në këto raste inspektori i minierave me të konstatuar se nuk ka licencë fillon procedurat e marra për evidentimin e operatorit ilegal dhe procedimin e rastit sipas qarkores së prezantuar.

- Në toka punuese kemi dëmtim të pronave –tokave punuese nga kufiri (mexhanikëve) i tokave përreth si pasoj e erozionit të kufirit të zonës ku është bërë shfrytëzimi dhe dëmtim i pronës nga pronari tjetër. (Figura 19. Foto 1 dhe 2)



Figura 19 Dëmtimi i arave përreth nga shfrytëzimi i rërave në toka punuese

Dëmtimi i pronave përreth edhe nëse operatori ka licencë nuk guxon të bëhet por shfrytëzimi përkaj me mekanikëve apo pronarëve përreth mund të bëhet vetëm atëherë ku kompania e licencuar për ta shfrytëzuar mineralin duhet të ketë marrëveshjen paraprake ndërmjet operatorit të licencuar dhe pronarëve të tokave punuese përreth.

- Shkaktim i rrezikut nga ri-kultivimi shpeshherë pa kriter nga hedhja e mbeturinave të rrezikshme ku si pasoj mund të infektohet rrjedha e ujërave nëntokësore si rezultat i infiltrimeve të ujit nga sipërfaqja në kontakt me mbeturinat si rezultat i përzierjes e ujit të pastër me mbetjet si rezultat i kontaminimit të ujërave. (Figura 20)



Figura 20 Ri kultivimi-mbushja me bërlllok i gropave te shfrytëzuara -kontaminimi i tokës me mbetje urbane - KPMM

Kjo është e ndaluar dhe menjëherë duhet të ndalet ky aktivitet, duhet lëshuar urdhëresë për ndalim të këtij aktiviteti duhet ngritur “kallëzim penal” dhe të obligohet kompania se duhet patjetër ta pastroj zonën e ri-kultivuar me materie të rrezikshme dhe se duhet zëvendësuar me material të nevojshëm ri-klutivues.

- Shkaktimi i rrezikut nga deponia— pellgjeve ujë mbajtëse ku mund të rrezikohen njerëzit që përdoren për freski gjatë stinës së verës, rrezikim për gjuetarë gjatë stinës së dimrit si pasoj e mos konstatimit se një zonë e tillë është e thellë. (Figura 21)



Figura 21 Krijimi i pellgjeve me ujë si pasojë e shfrytëzimit të rërave - KPMM

Këto zona duhet mbyllur nga operatori i cili ka shkaktuar këtë apo nga buxheti komunal i asaj komune që ka ndodhur kjo gjendje.

- Rreziku i dëmtimit të shtresës së dyshemesë se toka punues si pasojë e drenazhimit të zonës përreth zonës ku është bërë shfrytëzimi. (Figura 22. Foto 1 dhe 2)





Figura 22 Shfrytëzimi i inerteve në lum, dëmtimi i shtresës dyshemore të shtratit të lumit - KPMM.

Këto raste duhet ngritur “kallëzim penal” dhe menjëherë duhet proceduar lënda për keqpërdorim resursit dhe degradim ambianti.

Vendburimet të shkrifëta (argjila, rëra kuarcore, dheu dhe të ngjashme)

Për dallim nga inertet këto vendburime nuk gjenden në lumenj si përparësi, por ka anët e veta negative si:

- Në toka punuese kemi dëmtim të pronave –tokave punuese nga kufiri (mexhanikëve) i tokave përreth si pasoj e krijimit të shkallëve, lartësisë së madhe përgjatë kufirit ku në faza të vonshme kemi shembje nga mungesa e stabilitetit të shpatit të krijuar pa kriter. (Figura 23)
- Shkaktimi i rrezikut nga gropat – pellgjeve ujë mbajtëse ku mund të rrezikohen njerëzit që përdoren për freski gjatë stinës së verës, rrezikim për gjuetarë gjatë stinës së dimrit si pasoj e mos konstatimit se një zonë e tillë është e thellë. (Figura 24 fotografia 1 dhe 2)



Figura 23 Krijimi i deponisë me grumbull uji dhe dëmtim i kufirit të arave përreth - KPMM





Figura 24 Deponi uji nga shfrytëzimi i argjilave dhe rërave, pellgje degraduese dhe rrezik për njerëz - KPMM

- Lartësi të mëdha të krijimi të etazheve si lartësi për rrezikim nga rënia nga lartësia dhe
- Nuk behet asnjë lloje ri-kultivimi për mbylljen e hapësirës së shfrytëzuar me të cilën erozioni prish gjendjen topografike dhe krijohet imazh i keq ambiental. (Figura nga 19 deri 24)

Vendburimet mesatarisht të forta (rreshpet, rreshpet kuarcore, serperntinitet, qymyret etj)

- Në shfrytëzim në sipërfaqe kemi dëmtim të pronave –zakonisht gjinden të mbjella si : shkurre nga kufiri (mexhanikëve) i shkurreve si pasojë e krijimit të shkallëve, lartësisë së madhe përgjatë kufirit ku në fazë të vonshme kemi shembje nga mungesë të stabilitetit të shpatit të krijuar pa kriter. (Figura 25. Foto 1,2,3)





Figura 25 Shfrytëzimi i qymyreve ku shfrytëzimi bëhet pa kriter duke dëmtuar ambientin, shkaktim i rrezikut dhe dëmtim i pronave përreth vend-shfrytëzimit - KPMM.

- Në disa raste varësisht nga vendburimi kemi edhe depo të grumbullimit të ujit si rrezik nga fëmijët dhe kafshët për përmbytje.
- Lartësi të mëdha të krijimi të etazheve si lartësi për rrezikim nga rënia nga lartësia . (Figura 25,26)



Figura 26 Shfrytëzimi pa kriter, krijim lartësisë së shkallëve dhe mungesa e ri-kultivimi - KPMM

Rastet e tilla duhet ngritur “kallëzim penal dhe duhet sanuar gjendja nga niveli komunal ku ka ndodhur degradimi dhe shkaktimi i rrezikut.

Vendburimet të forta (gëlqeror të prishur tetoniksht, gëlqeror pllakor, hazburgite, serpentinite të freskëta, dunitë të kollapsuara, rreshpe sericitike etj)

- Është karakteristike se këto vendburime thellësia e shfrytëzimit të tyre për dallim nga vendburimet e cekura si me lartë është e cekët dhe kemi të bëjmë vetëm me dëmtim të korës sipërfaqësore që mund të dëmtohet flora dhe ambienti.
- Lajmërimet të gropave me thellësi të cekët dhe dëmtim i imazhit ambiental sipërfaqësor. (Figura 27. Foto 1,2,3 dhe Figura 28.)





Figura 27. Shfrytëzimin operatori ilegal nuk ka arritur ta bëjë në thellësi dhe ka arritur vetëm ta shfrytëzoj atë shtresë që i ka lejuar makineria. Degradim i terrenit dhe prishje ambientit - KPMM



Figura 28 Dëmtim i ambientit dhe rrezikim i shkallëve përfundimtare si shfrytëzim pa kriter - KPMM

VEPRIMTARIA E JASHTËLIGJSHME NË AKTIVITET TË VEÇANTA- KPMM

Aktivitetet e jashtëligjshme të veçanta nënkuptohen këto:

- Seperimi (Seperacionet)
- Përpunimi (Baza betoni dhe Asfalti) dhe
- Pasurimi (Flotacionet)

SEPERIMI

Seperimi ilegal nënkuptohet secili aktivitet i cili ushtron veprimtarinë e vetë pa leje dhe se ka të vendosur makinerinë në gjendje pune aktive.

Shkaktimi i rrezikut:

- Marrja e resursit mineral në përpunim nga operatorët ilegal ose me prejardhje nga vetë operatori i cili ka ndikim indirekt edhe në aktivitetet e shfrytëzimit. (Figura 29 Foto 1 dhe foto 2)





Figura 29 Aktiviteti i një seperim ilegal dhe marrja e resursit (rërës) në mënyrë ilegale - KPMM

- Shkaktim i ndotjes së ambientit nga pluhuri, zhurma dhe afërsia e ndërtimit të tyre afër shtëpive të banimit i pa kontrolluar dhe impiant i pa pranuar teknikisht.

Rastet e tilla duhet proceduar me kallëzime penale sipas qarkores pasi që operatorët nuk janë të pajisur me dokumentacionin para licencues me pëlqime ambientale dhe komunale.

PËRPUNIMI (BAZA BETONI DHE ASFALTI)

Përpunimi ilegal nënkuptohet secili aktivitet i cili ushtron veprimtarinë e vetë pa leje dhe se ka të vendosur makinerinë në gjendje pune aktive. Shkaktimi i rrezikut:

- Marrja e resursit mineral në përpunim nga operatorët ilegal- dhe aktiviteti i veçantë i seperimit ose me prejardhje nga vetë operatori i cili ka ndikim në aktivitet të shfrytëzimit. (Figura 30 Foto 1 dhe 2)



Figura 30 Aktiviteti ilegal i bazës së betonit dhe shfrytëzimi i resursit të përpunuar nga seperacionet - KPMM

- Shkaktim i ndotjes së ambientit nga pluhuri, zhurma dhe afërsia e ndërtimit të tyre afër shtëpive të banimit i pa kontrolluar dhe impiant i pa pranuar teknikisht.

Rastet e tilla duhet proceduar me “kallëzim penale” sipas qarkores pasi që operatorët nuk janë të pajisur me dokumentacionin para licencës me pëlqime ambientale dhe komunale.

PASURIMI (FLOTACIONET dhe PASURIMET E THËNGJILLIT)-KPM

Kjo dukuri nuk është prezentë sepse pasurimet përveç se janë të kushtueshme ato përdoren zakonisht si impiante të cilat pasurojnë xehen me përmbajtje metaleve dhe qymyreve ku aktiviteti i shfrytëzimit zakonisht bëhet me minime dhe ka kosto të lartë nxjerrjes dhe se qymyri është mineral i pa komercializueshëm për treg sipas LMM-së përjashtimisht fabrikës së Tertorës në Obiliq.

MMPH

BAZA LIGJORE - MMPH

Legjislacioni në fuqi

- Ligji nr. 04/I-175, për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit,
- Ligji Nr. 03/L-025, për Mbrojtjen e Mjedisit,
- Ligji nr. 03/I-214, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji Nr. 03/L-015 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor,
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma,
- Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit,
- Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes,
- Ligji nr. 04/I-197 për Kimikate,
- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës,
- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës,
- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor,
- Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim,

Përveç legjislacionit primar në Kosovë, legjislacioni sekondar në fushën e të drejtës së mjedisit në mënyrë tipike është lëshuar me autorizim të qartë nga një dispozitë ligjore për zbatimin e dispozitave të ligjit. Legjislacioni sekondar përbëhet nga:

- udhëzimet administrative – janë akte nënligjore që rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me
- një fushë të kufizuar të veprimi, (janë mbi 70 Udhëzime Administrative).
- vendimet - të cilat janë marrë nga autoriteti kompetent dhe në kuadër të autorizimeve të
- dhëna me ligj duke vendosur për emërimet, propozimet apo shkarkimet, si dhe për çështjet e tjera administrative që kërkojnë një vendim nga një autoritet përkatës, (janë po ashtu mbi 30 vendime)
- rregulloret – e lëshuara në bazë të autoritetit të dhënë me ligjin e caktuar dhe në përputhje
- me qëllimin dhe objektivat e ligjit përkatës, si dhe me vështirimin për rregullimin e çështjeve me të cilat ligji merret në detaje;

PËLQIMET, LICENCAT APO LEJET-MMPH

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave në MMPH administron gjithsej tridhjetë e tetë (38) lejime si në vijim, por ne do i paraqesim vetëm ato të cilat janë të domosdoshme:

Nr.	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
DMMU-13	Pëlqim për menaxhimin e të mirave të natyrës në zonat shkëmbore Neni 51 LMN nr.03/L-233, Propozohet të hiqet
DMMU-18	Leje për hulumtimin e vend-gjetjes së mineraleve, fosileve dhe shtresimeve Neni 111 LMN nr.03/L-233
DMMU-19	Leje për eksport të mineraleve, shtresimeve ose fosileve Neni 111 LMN nr.03/L-233
DMMU-20	Lejen për ndërhyrjet dhe punët në rezervatin strikt, zonën e veçantë, parkun kombëtar, parkun e natyrës dhe monumentin e natyrës Neni 34 LMN nr.03/L-233
DMMU-26	Licencimi i personave fizik hartues të raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Propozohet të hiqet me ndryshim plotësimin e ligjit të VNM)
DMMU-27	Licencimi i personave juridik që hartojnë raporte të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Propozohet të hiqet me ndryshim plotësimin e ligjit të VNM)
DMMU-36	Leje Mjedisore e Integruar
DMMU-37	Pëlqim Mjedisor
DMMU-38	Leje Mjedisore
ARPL-MMPH	Leje ujore për shfrytëzimin e ujit dhe shkarkimin e tij

Afati i kthimit të përgjigjeve për shumicën e Lejeve, Pëlqimeve dhe Licencave që lëshohen nga DMMU, e ka për bazë legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative përveç rasteve kur me ligj të veçantë është përcaktuar ndryshe.

1. Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-214, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (DMMU) në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) lëshon Pëlqim Mjedisore. Afati i Pëlqimit Mjedisor është i përhershëm nëse fillon aktiviteti i operatorit para periudhës dy vjeçare, në të kundërtën pushon vlefshmëria e Pëlqimit Mjedisor: Pëlqimi Mjedisore lëshohen për këto veprimtari të cilat në vete përfshin mbi 100 aktivitete:

- Prodhimi dhe procesimi i metaleve,
- Industria e mineraleve,
- Industria ekstraktuese,
- Industria kimike,
- Industria energjetike,

- Infrastruktura e transportit,
- Industria ushqimore,
- Trajtimi i mbeturinave dhe ujërave të shkarkuar,
- Projektet për depozitim, transport dhe furnizim të ujit,

Vendimi i Pëlqimit Mjedisor në formën e tij përmban këto të dhëna:

1. Datën e lëshimit,
2. Numrin e Referencës,
3. Emrin, aktivitetin dhe lokacionin e operatorit,
4. Emrin dhe nënshkrimin e Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe vulën e MMPH-së,
5. Emrin e dokumentit.

Vendimi i Pëlqimit Mjedisor është valid pas nënshkrimit dhe vulosjes së tij.

PËLQIMET MJEDISORE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

DATË/A:	XXXXXX
REFERENC-Ë:	XXXXXX/DMMU
PËR/ZA/TO:	XXXXXXXXXXXX
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	XXXXXXXXXXXXXXXX
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	XXXXXXXX

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Data e lëshuarjes së
Pëlqimit mjedisor

Nr. Referencës

Emri i kompanisë

Deperamenti i MMPH

Titulli i pëlqimit

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: XXXXXX/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

- 1.Vendimi për Pëlqim Mjedisor për operatorin, me veprimtari dhe lokacion.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 15

Përmbajtja e Raportit të VNM-së.

1. Raporti i VNM-së përmban:

1.1. përshkrimin e projektit, përfshirë në veçanti:

1.1.1. përshkrimin e karakteristikave fizike të projektit si tërësi dhe kushteve për përdorim të tokës, gjatë fazës së ndërtimit dhe të operimit;

1.1.2. përshkrimin e karakteristikave kryesore të procesit të prodhimit; 1.1.3. vlerësimin e përafërt, sipas llojit dhe sasisë së mbetjeve dhe emisioneve - ndotja e ujit, ajrit, tokës, zhurma, vibrimi, drita, nxehësia, rrezatimi jonizues dhe jo-jonizues, etj.- që rezultojnë nga projekti i propozuar.

1.2. paraqitja e alternativave kryesore të identifikuar nga ana e aplikuesit dhe dhënia e arsyeve kryesore për zgjidhjen e njëres prej tyre, duke i marrë parasysh efektet mjedisore;

1.3. një përshkrim të aspekteve mjedisore për të cilat ekziston mundësia e ndikimeve të theksuara negative nga projekti i propozuar, përfshirë, para së gjithash, popullatën, botën bimore dhe shtazore, tokën, ujin, ajrin, faktorët klimatik, vlerat materiale duke përfshirë trashëgiminë kulturore, arkitektonike dhe arkeologjike, peizazhin dhe raportet e ndërmjetme në mes të faktorëve të lartshënuar;

1.4. një përshkrim të ndikimeve të mundshme të theksuara të projektit të propozuar në mjedis si: ndikimet e drejtpërdrejta dhe çfarëdo ndikimi i tërthortë, sekondar, kumulativ, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, i përhershëm dhe i përkohshëm, pozitiv dhe negativ, që rezultojnë nga:

1.4.1. realizimi i projektit;

1.4.2. shfrytëzimi i resurseve natyrore;

1.4.3. emisionet e ndotësve, krijimi i shqetësimeve tjera dhe eliminimi i mbeturinave;

1.4.4. përshkrimi nga ana e aplikuesit të metodave parashikuese të përdorura për të vlerësuar ndikimet në mjedis. Këto ndikime duhet të përfshijnë ato që rezultojnë nga ndërtimet ose ekzekutimi i ndonjë projekti si dhe atyre që rezultojnë nga ekzistenca ose operacioni i projektit, pasi ai të jetë përfunduar.

1.5. një përshkrim, se si mund të ndikoj ose të ndikohet projekti i propozuar nga deponimi gjeologjik i CO₂ në zonat e deponimit

1.6. përshkrimi i masave të parapara për të parandaluar, zvogëluar dhe aty ku është e mundur mënjanimin e çfarëdo ndikimi të theksuar në mjedis;

1.7. Përmbledhjen Jo-Teknike të informatave të përshkruara më lartë;

1.8. shënimi i çfarëdo vështirësie - mangësive teknike ose mungesës së njohurive, në të cilat has aplikuesi gjatë hartimit të informatave të kërkuara.

Vërejtje:

Kjo përmbajtje është e njëjtë për të gjitha veprimtarit në ushtrim të veprimtarive të përgjithshme.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

DATË/A:	15.02.2019
REFERENC-Ë:	Numri i Protokolit/DMMU
PËR/ZA/TO:	Emri I operatorit dhe vendndodhja
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Sekretar i Përgjithshëm I MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: Numri i protokollit/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për bazën e betonit në Malishevë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Kompanisë “EMRI I OPRATORIT” Sh.p.k Lokacioni, për Pëlqim Mjedisor për veprimtaria e operatorit dhe lokacioni.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar si dhe pëlqimin e komunës të kompanisë “EMRI I OPERATORI” Sh.p.k Lokacioni, për Pëlqim Mjedisor për bazën e betonit në Lokacioni, në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-72310047-01376-1, numri i lëndes 2206-3018, Zona kadastrale Lokacioni. Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-214 për VNM, neni 20, është mbajtur debati publik, dhe me këtë rast, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i jep Pëlqim Mjedisor, për bazën e betonit, nën kushtet si vijon:

- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit, si dhe të tëra sipërfaqet funksionale;
- Të vendoset sistemi për trajtimin e ujërave industriale dhe ujërave atmosferike të cilat krijohen në sipërfaqet operacionale gjatë të reshurave (sedimentuesit dhe separatori për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga uji), para shkarkimit të tyre;
- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos së depos ku deponohen fuqitë e vajrave dhe derivateve, si dhe mbeturinat nga nusproduktet e krijuara gjatë procesit të prodhimit dhe larjes së auto mikserëve;
- Të bëhet monitorimi i përhershëm i filtrave të pluhurit, të dëmtuarit të ndërrohen;

- Të bëhet mbyllja hermetike e gypave dhe kanaleve për përcjelljen (transportin) e çimentos, të izolohehen të gjitha pikat gjeneruese të pluhurit.
- Të bahet monitorimi i emisioneve të pluhurit dhe ujërave që shkarkohen në mjedis;
- Rezultatet e kryera laboratorike të i raportohen Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bazë të marrëveshjes;
- Të vendosen pajimet adekuate për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe lëngta;
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terrenit dhe rregullimi i rrethojës së terrenit afër bazës së betonit;
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij.

Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura të i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (merret).

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 të Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 Nr.: Numri i Protokolit xx /xx datë: xx.xx.20xx
 Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Sekretar i Përgjithshëm

2. SHTOJCË: Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

LEJET MJEDISORE

Neni 31. Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.
2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.

Për veprimtarit e cekura me lart, bazuar ne ligjin nr. 03/L-025, për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017, për Leje Mjedisor, për të gjitha veprimtarit, për të cilat lëshohet Pëlqimi Mjedisor lëshohet edhe Leje Mjedisore. Leja mjedisore lëshohet sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë. Afati i Lejes Mjedisore është 5 vjeçar. Në vijim është paraqitur një draft vendim i Lejes Mjedisore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	xx.xx.20xx
REFERENC-Ë:	xx/xxxx/xx/DMMU
PËR/ZA/TO:	“EMRI I OPERATORIT” Sh.p.k. Lokacioni Veprimtaria, Eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Lokacioni.
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë EMRI I OPERATORIT” Sh.p.k. Lokacioni, me nr. prot. xx/xxxx/xxx/DMMU, të datës: xx.xx.20xx.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë “EMRI I OPERATORIT” Sh.p.k. Lokacioni, për veprimtaritë: eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Lokacioni.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Leje Mjedisore

Kompanisë “Xxx Sh.p.k. lokacion- komuna, për veprimtaritë: eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Lokacion-Komuna.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë “EMRI I OPERATORIT” Sh.p.k. Lokacioni, për veprimtaritë: eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, në ngastrat kadastrale: nr. xxx, zona kadastrale Lokacioni, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e Lejes Mjedisore.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike, vlerat kufitare të cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar;
- Raporti i rezultateve për monitorimin e cilësisë së ajrit sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të dorëzohet MMPH-së;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës të njoftoj MMPH;
- Sistemi i spërkatjes (me ujë) të jetë funksional;

- Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;
- Të i përmbaheni kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, sipas përshkrimit në aplikacion;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/2135/ZSP/ xxxx /19 datë: xx.xx.20xx.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së

Sekretar i Përgjithshëm

LEJET MJEDISORE TË INTEGRUAR

MMPH-ja bazuar në Ligjin nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes lëshon edhe **Leje Mjedisore të Integruar**. LMI është e vlefshme në afat prej dhjetë (10) vitesh. Ne vijim e keni draftin e një LMI.

LMI lëshohet sipas Aneksit I, të ligjit 03/L-043, për LMI dhe për këto aktivitete:

1. Industritë energjetike,
2. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve,
3. Industria e mineraleve,
4. Industria kimike,
5. Menaxhimi i mbeturinave,
6. Aktivitetet e minierave
7. Nxjerrja nëntokësore e burimeve minerale me një kapacitet nxjerrjeje që tejkalon njëqindmijë (100.000) ton në vit.
8. Nxjerrja sipërfaqësore e burimeve minerale në një vendndodhje që tejkalon njëzetepesë (25) hektarë, dhe
9. Aktivitetet tjera



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the Permanent Secretary

DATË/A:	
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	“EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Xxxx Xxxx , Sekretar i Përgjithshëm i MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore të Integruar

I/e nderuar,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar aplikacionin për Leje Mjedisore të Integruar të operatorit “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni me Nr. protokolit. Komisioni pasi ka zhvilluar një sere takimesh me përfaqësuesit të “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni dhe pas mbajtjes së Debatit Publik ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the Permanent Secretary

LEJA MJEDISORE E INTEGRUAR

Leja numër 2A.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke u bazuar në nenin 30, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Nr. 03/L-043, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2011 për Formën, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Plotësimit të Aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar dhe sipas kërkesës së operatorit “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni, bie këtë:

V E N D I M

Për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Operatorit: “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni

Adresa: “xx xx” Nr. xx, kodi-postar.

Kodi Postar Qyteti: xx -xx

Shteti: Republika e Kosovës

Numri i Regjistrimit të Kompanisë: xxxxxx

Zona Kadastrale: lokacioni

Numri i zonës kadastrale: xxxxxxxx

Numri i certifikatës: UL-xxxxxxx-xxxxx

Për operimin e Impiantit në: Lokacioni

Emri i plotë i impiantit: “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni

Aplikacioni i operatorit “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni dorëzuar me datë në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor është në përputhje me dispozitat e Ligjit Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes Nr.03/L-043.si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.03/2011 për Formën, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Plotësimit të Aplikacionit për Leje të Integruar.

Operatori në aplikacion ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas ligjit Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

Operatori e ka paraqit listën e pëlqimeve: Pëlqimi Mjedisor për deponinë lokacionin “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni dhe Aktiviteti. Të gjitha informatat e paraqitura në këtë aplikacion, aplikuesi i deklaron, të vërteta, të sakta, të plota dhe janë në dispozicion për publikut, si dhe dëshmi për pagesën e taksës administrative.

Komisioni ka shqyrtuar aplikacionin, ka zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni dhe me aktivitet

Pas përgatitjes së draftit të parë është mbajtur Debat i Publik me datën

Në përputhje me të dhënat e me sipërme Komisioni vlerëson se operatori “EMRI I OPERATORIT”, Lokacioni, ka plotësuar të gjitha kushtet për marrjen e **Lejes Mjedisore të Integruar**.

Nr.: //ZSP/ / datë:.

Prishtinë

T’i dërgohet:

1. Operatorit
2. Komisionit për LMI/DMMU-së
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Sekretar i Përgjithshëm

LICENCA PËR MENAXHIM ME TË GJITHA LLOJET E MBETURINAVE

Bazuar në Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Administrimit të Mbeturinave Nr.9/2014, DMMU-MMPH, lëshon edhe LICENCA për Menaxhim me të gjitha llojet e mbeturinave Mbeturina e cila përpilohet nga bordi. Afati i licencës është 5 vjeçar.



Operatori i cili duhet te aplikoj për LMK



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornong Planiranja
Ministry of Environment And Spatial Planning
Departamenti për Mbrotjen e Mjedisit dhe Ujërave
Department of Environment Protection and Waters
Departament za Zaštitu Sredine i Voda

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:		Kërkesa nr. protokolli xx/xxx/x-xxx-DMMU, datë xx.xx.20xx			
PËR/ZA/TO:		Sekretar i përgjithshëm i MMPH			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		xxxt xxx, drejtor i DMMU			
NGA/OD/FROM:		Xx Xxx, kryesues i Bordit			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Vendim i Bordit për Licencimin e menaxhimit të mbeturinave për kompaninë : “EMRI I OPERATORIT” Lokacioni.			
Nr. i zyrës:	1517	Lokacioni:	Objeki Qeveritar - Ish	Data:	xx.xx.20x
Br. kancelarije:		Kucni:	Rilindja Kati XV	Datum:	x
Room No.:		Extension:		Date:	
Për AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/for action					☒
Për MIRATIM/ZA USVAJANJE/for approval					☒
Për NËNSHKRIM/ZA POTPIS/for signature					☒
Për KOMENTE/ZA KOMENTARE/for comments					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/may ëe discuss					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/your attention					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/as discussed					☐
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/as requested					☒

SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN	☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/for your information	☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE	

Bordi i formuar me vendimin e Ministrit, nr. xx/20xx protokoluar me nr. xxx/xx të datës xx.xx.20xx, për Vlerësimin dhe Lëshimin e Licencës për Menaxhimin e Mbeturinave, në mbledhjen e mbajtur më datë 17.06.2019, shqyrtoi kërkesën me nr. protokollit 2596/19, datë 02.05.2019 të kompanisë “EMRI I OPERATORIT” Lokacionin dhe duke u bazuar në nenin 55 të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Administrimit të Mbeturinave Nr.9/2014 Bordi vlerësoj se aplikuesi “EMRI I OPERATORIT” Lokacioni., i plotëson kushtet për menaxhimin e mbeturinave dhe propozon që Ministri i MMPH, të miratoj këtë:

V E N D I M

1. Licencohet kompania “EMRI I OPERATORIT” Lokacioni, për Qendrën/objektin në për veprimtarinë:
2. Mbledhje, grumbullim, magazinim dhe trajtim fizik të vajrave dhe yndyrave ushqimore me Nr. të KEM: 200125. Sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Mbeturina nr. 04/L-060 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2014,
3. Parashtruesi i kërkesës nga pika 1, është përgjegjëse për dëmet eventuale mjedisore të cilat i shkakton gjatë menaxhimit të mbeturinave.
4. Parashtruesi i kërkesës nga pika 1, është i detyruar të paraqes raport në MMPH sipas nenit 29, të Udhëzimit administrativ Nr. 09/2014 dhe që të përmbushë detyrimet ligjore në bazë të cilave është lëshuar licenca.
5. Afati i licencës është pesë (5) vjet nga dita e licencimit.
6. Parashtruesi i kërkesës nga pika 1, përfaqësohet nga Xxxx Xxxx me Nr. personal të Identifikimit 1xxxxxxx, në cilësinë e drejtuesit teknik dhe përgjegjës profesional.

A r s y e t i m

Bordi për vlerësimin dhe lëshimin e licencës për menaxhimin e mbeturinave i MMPH, shqyrtoi kërkesën nr. i protokollit 2596/19, datë xx.xx.20xx të “EMRI I OPERATORIT” Lokacioni. me nr. Biznesi, vlerësoi se aplikuesi i plotëson kushtet për licencimin e menaxhimit të mbeturinave nga pika 1, e këtij Vendimi, për çka Vendimi për licencim u mor si në diapozitiv.

LEJET UJORE

Ndërsa bazuar në Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2018 për procedurat për Leje Ujore, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumorë (ARPL) në kuadër të MMPH-së, lëshon Kushte Ujore, Pëlqim Ujore të cilat janë kushte për të marr Lejen Ujore. Afati i Lejes Ujore sillet nga 2 deri 25 vjet. Pëlqim Ujore dhe Leje Ujore, lëshohet për këto veprimtari:

- Nxjerrje të ujit për konsum të përgjithshëm,
- Shkarkim të ujërave të ndotura,
- Shkarkimin indirekt në ujëra nëntokësore,
- Shtimin artificial të ujërave nëntokësore,
- Ndërtimin, rindërtimin ose demolimin e objekteve dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin ujqor dhe ne pronën ujore,
- Aktiviteti i rregullimit të ujë rrjedhave
- Aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave,
- Ndërtimi dhe rregullimi i deponive,
- Për hulumtime hidro-gjeologjike dhe grumbullimin e të dhënave,
- Eksploatin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilat,
- përdorimi i ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale dhe
- Aktivitete tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor.
- Dhe disa aktivitete tjera.

- Procedurat për leje ujore tek shfrytëzuesit e operimit me inerte (separacion, gurëthyes, etj), të cilët aplikojnë për shfrytëzim të ujit, shkarkim të ujit nga prodhimi dhe nxjerrje inerteve nga shtrati i lumit, janë paraqitur si më poshtë:

- Pala aplikon për të marrë të drejtë për shfrytëzim të resursit ujqor, në ARPL-MMPH dhe futet në procedurë sipas kritereve të parapara në Ligjin për Ujëra të Kosovës Nr.04/L-147 dhe UA, Nr.03/2018, Për Procedurat për Leje Ujore.

1. Çka nënkupton kushte ujore?

- Me kushte ujore vendoset mbi ekzaminimin e kushteve për realizimin e së drejtës ujore sipas kërkesës së paraqitur në lokacionin konkret dhe për destinimin konkret, përcaktohen kushtet të cilat duhet ti plotësojnë dokumentacionin për ndërtimin e objekteve dhe realizimin e aktiviteteve.
- Krahas kushteve ujore duhet bashkangjitur edhe dokumentacionin të cilin e kemi prezantuar në figurën në vijim.

Të dhënat e aplikantit:		I autorizuar: Jo ☐ Po ☐
Emri dhe mbiemri / emri i biznesit:		
ID personale/ numri i biznesit:		
Adresa:		
Nr.tel/ e-mail:		

Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

AUTORITETI I RAJONIT TE PELLGJEVE LUMORE
Kati XVI / Zyra 1603/Ndërketa e ish Rilindjes, 10000 Prishtinë

APLIKACIONI PER KUSHTE UJORE	
Te dhënat e objektit ose aktivitetit : (te dhënat baze te objektit ose aktivitetit,lloji,destinimi e ngjashëm) Qëllimi: (qëllimi dhe destinimi i ndërtimit te objektit ose aktivitetit) Lokacioni: (Te dhënat mbi lokacionin e objektit planifikuar ose aktivitetit:Komuna,zk,parc) Arsyet shtese:	

Aplikacionit varësisht nga qëllimi i objektit ose aktivitetit i bashkëngjitet:

1. Kopja e vërtetuar e certifikatës së biznesit dhe numrit fiskal;
2. Kopja e vërtetuar e ID;
3. Dëshmi mbi pagesën e tarifave administrative;
4. Autorizimi mbi përfaqësimin e aplikuesit;
5. Studimi i hartuar nga personi juridik i cili i plotëson kushtet dhe kriteret sipas këtij udhëzimi;
6. Certifikata mbi pronësinë (lëshon zyra komunale e regjistrimit të tokës);
7. Kopja e planit kadastral e lëshuar nga organi kompetent /me të dhënat mbi paluajtshmërinë, trashëgiminë e tjera;
8. Situacioni i lexueshëm i terrenit me shënimin e lokacionit në 1:1000 – 1:5000;
9. Mendimin mbi përputhshmërinë e aktivitetit të planifikuar me dokumentet e planifikimit hapësinor të lëshuara nga ana e organit kompetent për planifikim hapësinor;
10. Dokumentacionin mbi hulumtimet e deritanishme,dhe
11. Dokumentacioni tjetër sipas kërkesës së Autoritet të rajonit të pellgjeve lumore.

Data dhe vendi:

V.V

Nënshtkrimi i Aplikuesit:

(nënshtkrimi personit përgjegjës)

Mbi përmbajtjen e studimit, shënimet paraqiten ne fletën e dytë (rrrotullo!

Të dhënat e aplikantit:		I autorizuar: Jo ☐ Po ☐
Emri dhe mbiemri / emri i biznesit:		
ID personale/ numri i biznesit:		
Adresa:		
Nr.tel/ e-mail:		

Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

AUTORITETI I RAJONIT TE PELLGJEVE LUMORE
Kati XVI / Zyra 1603/Ndërketa e ish Rilindjes, 10000 Prishtinë

APLIKACIONI PER LEJE UJORE	
Te dhënat e objektit ose aktivitetit : (te dhënat baze te objektit ose aktivitetit,lloji,destinimi e ngjashëm) Qëllimi: (qëllimi dhe destinimi i ndërtimit te objektit ose aktivitetit) Lokacioni: (Te dhënat mbi lokacionin e objektit planifikuar ose aktivitetit:Komuna,zk, parc) Te dhënat mbi Dokumentacionin projektues (Numri dhe data e dokumentit të lëshuar, emri organit i cili e ka lëshuar) Te dhënat mbi lejen e lëshuar te ndërtimit (Numri dhe data e dokumentit të lëshuar,emri organit i cili e ka lëshuar)	

Aplikacionit varësisht nga qëllimi i objektit ose aktivitetit i bashkëngjitet:

1. Kopja e vërtetuar e ID ose certifikatës së biznesit (vetëm për persona juridik);
2. Kopje e vërtetuar e certifikatës së numrit fiskal;
3. Dëshmi mbi pagesën e tarifave administrative;
4. Autorizimi mbi përfaqësimin e aplikuesit;
5. Kopja e vendimit mbi lejin e ndërtimit;
6. Kopja e vendimit të Pëlqimit Ujorë;
7. Projekt i gjendjes së zbatuar
8. Rregulloret(akt i përgjithshëm) mbi mirëmbajtjen,shfrytëzimin dhe vëzhgimin e objektit ujorë dhe sjelljen ne rast te dëmeve ose avarive;
9. Programin i aprovuar i monitorimit dhe raportimit(periodik ose vjetor)mbi testimin dhe vlerësimin e kushtetit te ujrave te ndotura;
10. Te dhënat mbi lejen e lëshuar mjedisore,kushteve ndërtimore ose kopjet e vendimeve te lëshuara
11. Dokumentacioni tjetër sipas kërkesës së Autoritetit të rajonit të Pellgjeve

Data dhe vendi:

V.V

Nënshtkrimi i Aplikuesit:

(nënshtkrimi personit përgjegjës)

Figura 31 Aplikacioni për kushte ujore – MMPH

Figura 32 Aplikacioni për Pëlqim Ujorë - MMPH

Çka nënkupton Pëlqim Ujor?

- Me pëlqim ujorë verifikohet se dokumentacioni i bashkangjitur aplikacionit për pëlqim ujorë është hartuar në përputhje me kushtet ujore legjislacionin e ujrave dhe dokumentacionet planifikuese për rajonin përkatës.
- Krahas aplikacionit për pëlqim ujorë, duhet bashkangjitur edhe dokumentacionin i cili është i paraqitur në aplikacion.
- Leja ujore sigurohet për të gjitha objektet dhe aktivitetet me të cilat me dispozita ligjore është përcaktuar lëshimi i pëlqimit ujorë, me përjashtim të nxjerrjes së materialit nga ujë rrjedhat dhe rregullimi i ujë rrjedhave dhe ujërave tjera.
- Krahas aplikacionit për leje ujore operatori duhet bashkangjitur edhe dokumentacionin i cili është prezantuar në aplikacion

Si duken këto dokumente, (kushtet, pëlqimi dhe leja), kopje me foto?

Të dhënat e aplikantit:	I autorizuar: Jo ☐ Po ☐
Emri dhe mbiemri / emri i biznesit:	
ID personale/ numri i biznesit:	
Adresa:	
Nr.tel/ e-mail:	

Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Mjeddit dhe Planifikimit
Hapësiror

AUTORITETI I RAJONIT TE PELLGJEVE LUMORE

Kati XVI/Zyra 1603/Ndërtesa e ish Rilindjes,
10000 Prishtinë

APLIKACIONI PER LEJE UJORE

Te dhënat e objektit ose aktivitetit : (te dhënat baze te objektit ose aktivitetit,lloji,destinimi e ngjashëm)	
Qëllimi: (qëllimi dhe destinimi i ndërtimit te objektit ose aktivitetit)	
Lokacioni: (Te dhënat mbi lokacionin e objektit planifikuar ose aktivitetit:Komuna,zk, parc)	
Te dhënat mbi Dokumentacionin projektues (Numri dhe data e dokumentit të lëshuar, emri organit i cili e ka lëshuar)	
Te dhënat mbi lejen e lëshuar te ndërtimit (Numri dhe data e dokumentit te lëshuar,emri organit i cili e ka lëshuar)	

Aplikacionit varësisht nga qëllimi i objektit ose aktiviteit e bashkëngjitet:

- Kopja e vërtetuar e ID ose certifikatës së biznesit(vetëm për persona juridik);
- Kopje e vërtetuar e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshmi mbi pagesën e tarifave administrative;
- Autorizimi mbi përfaqësimin e aplikuesit;
- Kopja e vendimit mbi lejimin e ndërtimit;
- Kopja e vendimit te Pëlqimit Ujore;
- Projekt i gjendjes se zbatuar
- Regullore(akt i përgjithshëm) mbi mirëmbajtjen,shfrytëzimin dhe vëzhgimin e objektit ujore dhe sjelljen ne rast te dëmeve ose avarive;
- Programin i aprovuar i monitorimit dhe raportimit(periodik ose vjetor)mbi testimin dhe vlerësimin e kualitetit te ujrave te ndotura;
- Te dhënat mbi lejen e lëshuar mjedisore,kushteve ndërtimore ose kopjet e vendimeve te lëshuara
- Dokumentacioni tjetër sipas kërkesës se Autoritetit te rajonit te Pelligjeve

Data dhe vendi:

Nënshkrimi i Aplikuesit:

(nënshkrimi personit përgjegjës)

V.V



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelaria Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

DATE/A:	XXXXXX
REFERENC-Ë:	XXXXXX ARPL / 2019
PËR/ZA/TO:	XXXXXXXXXX
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	XXXXXXXXXX
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	XXXXXXXXXX

Sipas kërkesës tuaj me nr. të protokollit xxxxxx, organi kompetent i MMPH-së ka shqyrtuar aplikacionin për dhe ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letrë përcjellëse.

Nr. i protokollit të operatorit

Data e lëshimit të Vendimit

Numri i Protokollit

Operatorin

Sekretari i Përgjithshëm,
Nenshkrimi dhe Vula, MMPH-së

Leje ujore ose Pelqim
Ujorë , Kushte Ujore

Si ushtron veprimtarinë një ndërmarrje me dokumentacion nga MMPH-ja?

Që kompania ta filloj veprimtarin e vet në mënyrë ligjore dhe legale para fillimit të aktivitetit duhet të aplikoj dhe të pajiset me:

1. Pëlqim Ujore,
2. Leje Mjedisore,
3. Leje Te integruar Mjedisore,
4. Leje Ujore,

PROCEDURAT E LESHIMIT NJË PELQIMI APO LEJE-MMPH


Si duhet të veprojnë një operator për tu pajisur me dokumentacionin adekuat për ta vazhduar punën apo aktivitetin e vetë minerar apo me aktivitet të veçantë?

Operatori për të zhvilluar një aktivitet i duhet të merr këto dokumentacione:

1. Pëlqim, ekstrakt, njoftim komunal me të cilin tregohet se nuk pengon komune aktiviteti në fjalë,
2. Komunitat lëshoj edhe Leje Mjedisore komunale, për baza për prodhim të betonit në 2 (m³/orë),
3. Pëlqim Mjedisore,
4. Licencë për aktivitet nga KPMM,
5. Leje Mjedisore
6. Leje Mjedisore të Integruar,
7. Pëlqim Ujor dhe
8. Leje Ujore për shfrytëzimin e ujit dhe Shkarkimin e tij.

Në vijim keni:

Skema 2: Organo gram i përgjegjësive dhe dokumenteve valide funksionale ndërmjet institucioneve.
Organogrami per pajisje me pëlqim, leje, licenca etj.



Kush është ai organ që duhet njoftuar për tërheqjen e pëlqimit?

Institucioni KPMM-ja i cili ka kërkuar pëlqimin mjedisor si parakusht për lëshuarjen e licencës apo lejes së aktiviteteve të veçanta. Nga MMPH-ja, operatori i cili është punuar sikur në foton-figurën 35 deri 40, si në vijim duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore.



Figura 35 Largimi i mbulesës si fazë përgatitore e fillimit të punëve minerare - MMPH



Figura 36 Aktiviteti i përgatitjes së fushës për minim - MMPH.



Figura 37 Aktiviteti mineralar përgatitja e fushës për minim - MMPH



Figura 38 Fillimi i ndërtimit një shkallë punuese minerare - MMPH



Figura 39 Shkallët përfundimtare - MMPH



Figura 40 Ri-kultivimi i shkallëve të minierës me ri-kultivim - MMPH

A punohet në këto veprimtari edhe nga personat juridik apo fizik pa licencë dhe leje?

Po, këto veprimtari të cekura me lart, punohen edhe pa dokumentacion përkatës ligjore nga personat fizik dhe juridik. Por veprimi i tillë është ilegal.

KLASIFIKIMI I OPERIMEVE ILEGALE MINIERARE-MMPH

Si konsiderohet një veprimtari e jashtëligjshëm ilegale minerare sipas Ligjit të MMPH?

Një veprimtari ilegale sipas bazë ligjore të MMPH-së konsiderohet nëse nuk posedon dokumentet si në vijim:

1. Pëlqim mjedisor,
2. Leje Mjedisore,
3. Leje Ujore.

Pëlqim mjedisor

Sipas ligjit nr. 03/L-025, për Mbrojtjen e Mjedisit, përkatësisht në nenin 10 theksohet:

Neni 10

“Asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor”.

Po ashtu sipas ligjit nr. 03/L-214, për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në neni 7 thekson:

Neni 7 Obligimi për Pëlqim Mjedisor

1. Një Pëlqim Mjedisor do të kërkohet për secilin projekt publik ose privat të renditur në Shtojcën I ose Shtojcën II të këtij ligji, i cili mund të ketë efekte të theksuara në mjedis për arsye të, inter alia, natyrës së tij, madhësisë ose lokacionit.
2. Të gjitha projektet e përcaktuara në Shtojcën I, janë të obliguara t'i nënshtrohen VNM-së.
3. Projektet e renditura në Shtojcën II, do të ekzaminohen, rast për rast dhe në pajtim me kriteret e cekura në Shtojcën III, për të përcaktuar, nëse ata duhet ti nënshtrohen VNM-së.
4. Ministria nuk do të lëshoj Pëlqimin Mjedisor, të referuar sipas paragrafit 1., të këtij neni, derisa të mos jetë bërë Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis për projektin.
5. Aplikuesit nuk i lëshohet leja për ndërtim ose ndonjë leje tjetër, për ndonjë projekt të referuar në paragrafët 1. dhe 2., të këtij neni dhe ai nuk mund të filloj ekzekutimin e projektit, përderisa të mos i lëshohet Pëlqimi Mjedisor nga ana e Ministrisë.
6. Ministria mund të lejoj për rastet e veçanta moskryerjen e VNM për projekte me qëllim të mbrojtjes nacionale, me vendim të Qeverisë.

Sipas ligjit nr. 03/L-025, UA 07-2017 dhe per LM. për mbrojtjen e mjedisit, Neni 31, Thekson:

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.
2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesë vjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.
3. Ministria, me akt nënligjor, përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, formën e aplikimit, përmbajtjen e lejes mjedisore, revokimin e lejes, vazhdimin e vlefshmërisë si dhe regjistrin e lejeve të lëshuara.

Sipas Ligjit nr. 04/L147, për Ujërat e Kosovës, Neni 56 thekson:

Mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit të ujërave me nxjerrjen e inerteve nga shtretërit dhe brigjet e trupave uJOR sipërfaqësorë

1. Me qëllim të mbrojtjes së regjimit të ujërave, shtratit dhe brigjeve të lumit, nxjerrën inertet - rëra, zhavorri dhe gurët, nga trupat uJorë sipërfaqësor në segmente të caktuara.
2. Përcaktimi i segmenteve ku mund të nxirret rëra, zhavorri dhe gurët, bëhet në harmoni me Strategjinë shtetërore të ujit dhe Planin për menaxhimin e pellgut lumor.
3. Deri me aprovimin e Strategjisë shtetërore të ujit dhe Planit për menaxhimin e pellgut lumor, kjo çështje zgjidhet me vendim nga Ministria.
4. Nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurëve nga trupi uJOR sipërfaqësorë, kryhet në kushtet, mënyrën dhe procedurën sipas lejes uJore.

Sipas neni 70 thekson:

Fitimi dhe kushtet e fitimit të së drejtës uJore

Fitimi i së drejtës uJore, sigurohet:

- a) me leje uJore;
 - b) me koncesion.
2. Bartësi i të drejtës uJore shfrytëzon ujin sipas kriterëve të përcaktuara me aktin për fitimin e së drejtës uJore.
 3. Koncesioni, përkatësisht partneriteti publik dhe privat kryhet në kushte, mënyra dhe procedura për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujërave të caktuara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Leja ujore

Ndërsa neni 72 thekson:

Leja ujore lëshohet për:

- 1.1. nxjerrje të ujit për konsum të përgjithshëm;
- 1.2. shkarkim të ujërave të ndotura;
- 1.3. ndërtimin, rindërtimin ose demolimin e objekteve dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin ujqor; 1.4. aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave;
- 1.5. për hulumtime hidrogeologjike dhe grumbullimin e të dhënave;
- 1.6. eksploatimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilit;
- 1.7. përdorimi i ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale; dhe
- 1.8. aktivitete tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor.

2. Leja ujore nuk është e nevojshme për: shfrytëzimin e puseve, burimeve, cisternave dhe objekteve të ngjashme për furnizimin e një amvisërie me ujë të pijshëm, fikjen e zjarreve dhe ndërmarrjen e masave urgjente sanitare dhe masave tjera në rast të rrezikut të përgjithshëm.

3. Me Lejen Ujqore përcaktohet destinimi, mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të ujit, shkarkimi i ujërave të ndotura, regjimi i punës së objekteve dhe impianteve, deponimi i mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta si dhe kushtet tjera.

Leja Ujqore, sipas këtij ligji, për shfrytëzimin e ujërave ndërkufitare dhe shkarkimin e ujërave të ndotura në ujërat ndërkufitare jepet në pajtim me marrëveshjen ose konventën ndërkombëtare.

5. E drejta e shfrytëzimit ose shkarkimit të ujërave të ndotura, e fituar në bazë të lejës ujore, nuk mund të bartet në persona tjerë, pa pëlqimin e autoritetit kompetent.

6. Ministria lëshon lejet ujore me akt nënligjqor, Ministria mund të delegojë kompetenca për të cilat komunat dhe Autoriteti, mund të lëshojnë leje ujore.

7. Leja Ujqore rishqyrtohet së paku në çdo pesë (5) vjet.

8. Bartësi i të drejtës ujore, detyrohet t'a informojë lëshuesin e lejes, në rast të ndryshimit në veprim, teknologji dhe shfrytëzim të ujit apo në raste tjera, kur mund të kenë ndikim të rëndësishëm në regjimin ujqor.

AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË HULUMTIM-MMPH

MMPH-ja nuk lëshon asnjë pëlqim për licenca të hulumtimit për shfrytëzimin e resurseve minerare përjashtimisht nëse kjo kërkohet nga organi i cili lëshon licenca.

Sqarim: KPMM tek licencat e hulumtimit ku kompanitë për hulumtim kanë resurset minerale rërë dhe zhavorr kërkohet edhe pëlqimi mjedisor.

AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË SHFRYTËZIM-MMPH

Të gjitha aktivitetet e shfrytëzimit minerar nga personat fizik dhe juridik, konsiderohen si te jashtëligjshme ato të cilat nuk janë të pajisura me lejet-dokumentet si në vijim:

1. Pëlqim mjedisor,
2. Leje Mjedisore,
3. Leje Ujore.

AKTIVITET ILEGALE ME PASOJA DEGRADUESE AMBIENTALE DHE SHKAKTIMI I RREZIKUT-MMPH

Pasoja e një aktiviteti ilegal në shfrytëzim manifestohet me shkaktim i degradimit ambienti dhe rrezikut për njerëz dhe kafshë si :

Vendburimet Inerte (rërë dhe zhavorr)

- Në foto ne vijim të cilat paraqesin degradim, ndërhyrje në rrjedhën e lumit-devijimi i tij, shkatërrimi i shtratit të lumit, dëmtim i shtresave ujëmbajtëse nëntokësore etj, nga shfrytëzimi i inerteve të lumit-rërës dhe zhavorrit janë veprime ilegale të cilat ndalohen nga Ligji nr. 04/L-147, për ujërat e Kosovë, përjashtimisht kur operatori pajiset me leje ujore për rregullim të shtratit të lumit, pastrimin e tij, ndërtimin e infrastrukturës rrugore, apo veprimeve infrastrukturore të marrjes së ujit etj.







Figura 41 Shfrytëzimi ilegal në lumenj dhe prishja e shtratit të lumit - MMPH

Ndërhyrja edhe në sipërfaqet e tokave si në foto 1 dhe 2, dhe janë jashtë rrjedhës së lumenjve, paraqet degradim mjedisor, pa dokumentet përkatëse ligjore që lëshohen nga MMPH-ja, konsiderohen ilegale-të jashtëligjshme.



Figura 42 Dëmtimi i arave përreth nga shfrytëzimi i rërave në toka punuese - MMPH

- Ri-kultivimi si në figurën 43, është veprim ilegal dhe nga MMPH-ja nuk lëshohet asnjë dokument për ri-kultivimin si ne këtë figurë. Për veprime të tilla menjëherë duhet marrur masat parandaluese të degradimit , duhet sanuar gjendja e krijuar me mase të pranuar ri-kultivuese.



Figura 43 Ri kultivimi-mbushja me bërlllok i gropave te shfrytëzuara -kontaminimi i tokës me mbetje urbane - MMPH

-Në figurë veprim ilegal, degradim me rrezikshmëri të lart për jetën e qytetarëve sidomos fëmijëve gjatë sezoneve të nxehta.



Figura 44 Krijimi i pellgjeve me ujë si pasoj e shfrytëzimit të rërave - MMPH

Në figurën 45, paraqitet degradim mjedisor nga veprimi ilegal ne rrjedhën e lumi, rrezik i madh për jetën e qytetarëve.



Figura 45 Shfrytëzimi i inerteve në lum, dëmtimi i shtresës dyshemore të shtratit të lumit - MMPH.

Vendburimet të shkrifëta (argjila, rëra kuarcore, dheu dhe të ngjashme)

- Edhe për vendburimet me resurse të tilla si në figurën 46, dhe foto 1 dhe 2, për të u shfrytëzuar në mënyrë legale nevojiten; Pëlqimi Mjedisore dhe Leja Mjedisore, në të kundërtën veprimi është ilegal apo kundërligjshëm.



Figura 46 Krijimi i deponisë me grumbull uji dhe dëmtim i kufirit të arave përreth - MMPH





Figura 47 Deponi uji nga shfrytëzimi i argjilave dhe rërave, pellgje degraduese dhe rrezik për njerëz - MMPH

Mënyra e operimit nuk paraqet veprimtari ilegale por paraqet keq shfrytëzim të resursi në mos përputhje me kushtet e operimit sipas dokumentacionit përkatës dhe për të cilën operatori ndëshkohet nga Inspektorati.

Vendburimet mesatarisht të forta (rreshpet, rreshpet kuarcore, serperntinitet, qymyret etj)

Te vend shfrytëzimi i rreshpet, rreshpet kuarcore, serperntinitet, si ne foto 1, 2 dhe 3 si dhe ne figure 49, për operime legal nga MMPH-ja, nevojitet që operatori të ketë Pëlqim Mjedisor dhe Leje Mjedisore ndërsa në të kundërtën veprimi është ilegal.

Ndërsa sa i përket eksploatimi-shfrytëzimit, tregtimit-shitjes dhe transportimit të thëngjillit përveç KEK-ut për shfrytëzim dhe Kosova Thëngjillit për tregtim, operatorët tjerë që operoj janë plotësisht ilegal, sepse MMPH-ja nuk lëshon dokumentet për këtë veprimtari.





Figura 48 Shfrytëzimi i qymyreve i cili bëhet pa kriter duke dëmtuar ambientin, shkaktim i rrezikut dhe dëmtim i pronave përreth vend-shfrytëzimit – MMPH.



Figura 49 Shfrytëzimi pa kriter, krijim lartësisë së shkallëve dhe mungesa e ri-kultivimi - MMPH

Të shfrytëzimet e tilla përveç degradimit mjedisor thuaj të pa riparueshme shqetësim mjaft i madh mbetet edhe rreziku për jetën e qytetarëve dhe kafshëve nga lartësia e skarpates – shkallës së shfrytëzimit, grumbullimin e ujërave nëntokësore, shembja e dheut etj.

Vendburimet të forta (gëlqeror të prishur tetoniksht, gëlqeror pllakor, hazburgite, serpentinite të freskëta, dunite të kollapsuara, rreshpe sericitike etj)

Edhe për shfrytëzimin e Vendburimeve të forta (gëlqeror të prishur tektoniksht, gëlqeror pllakë, hazburgite, serpentinite të freskëta, dunite të kollapsuara, rreshpe sericitike etj, si ne foto 1, 2 dhe 3 dhe ne figurën 50, nga MMPH-ja, lëshohen Pëlqime Mjedisore dhe Leje mjedisore, ndërsa për raste kur operatori nuk posedon dokumentet e cekura me lart është duke kryer veprimtari ilegale-të jashtëligjshëm. Mirëpo nga operimet e tilla si ne fotot 1, 2 dhe 3 dhe figurën 50, janë të shprehura degradime te mëdha te mjedisor dhe natyrës dhe edhe nëse operatori posedon dokumentacion kjo mënyrë e ekspluatimit nuk duhet të lejohet.





Figura 50. Shfrytëzimin operatori ilegal i cili nuk ka arritur ta shfrytëzoj në thellësi por vetëm atë shtresë nga makineria. Degradim i terrenit dhe prishje ambientit - MMPH



Figura 51 Dëmtim i ambientit dhe rrezikim i shkallëve përfundimtare si shfrytëzim pa kriter – MMPH

VEPRIMTARIA E JASHTËLIGJSHME NË AKTIVITET TË VEÇANTA-MMPH

Lidhur me aktivitetet e Seperimit, Bazave të Betonit, Bazave të Asfaltit dhe Flotacioneve për pasurimin e xeheve, nga MMPH-ja lëshohen këto dokumente:

1. Pëlqim Mjedisor,
2. Leje Mjedisore,
3. Leje ujore dhe
4. Leje Mjedisore të Integruar.

Për të kryer veprimin legal një Seperacion si në foto 1 dhe 2 në figurën 52, operatori nga MMPH-ja duhet të pajiset me Pëlqim Mjedisor, Leje Mjedisore dhe Leje Ujore (Leje Ujore për shfrytëzimin e ujit dhe Leje ujore për Shkarkimin e ujit). Në të kundërtën veprimtaria është ilegale.



Figura 52 Aktiviteti i një seperim ilegal dhe marrja e resursit (rërës) në mënyrë ilegale - MMPH

-Problemet kryesore që i shkaktojnë seperacionet janë: degradimi i mjedisit, pluhuri, zhurma dhe ndotja e ujërave, demtimi i shtresave nëntoksore ujëmbajtëse etj. Të gjitha këto kushte parashihen ne dokumentet e lëshuara nga MMPH-ja.

PËRPUNIMI (BAZA BETONI DHE ASFALTI)-MMPH

-Për të kryer veprimin legal në Bazë Betoni si ne foto 1 ne figurën 53, operatori nga MMPH-ja duhet të pajisem me Pëlqim Mjedisor, Leje Mjedisore dhe Leje Ujore (Leje Ujore për shfrytëzimin e ujit dhe Leje ujore për Shkarkimin e ujit). Në të kundërtën veprimtaria është ilegale.

Ndërsa për baza të Asfaltit operatori që të operoj në mënyrë legale nga MMPH-ja duhet të pajiset me Pëlqim Mjedisor dhe Leje Mjedisore. Në të kundërtën operimi është ilegal.



Figura 53 Aktiviteti ilegal i bazës së betonit dhe shfrytëzimi i resursit të përpunuar nga seperacionet - MMPH

Nga bazat e Betonit dhe Asfaltit, ndotjet kryesore ne mjedis janë: ndotja e ajrit, ujërave, zhurma dhe krijimi i mbeturinave (të ngurta dhe vajra).

PASURIMI (FLOTACIONET dhe PASURIMET E THËNGJILLIT)-MMPH

-Lidhur me veprimtarin e pasurimit- flotacionit, për veprim legal të operatorve, MMPH-ja lëshon këto dokumentacione:

1. Pëlqim Mjedisor,
2. Leje Mjedisore,
3. Leje ujore dhe
4. Leje Mjedisore të Integruar.

Për kompanitë për pasurimin e xehes- flotacionit, MMPH-ja lëshon: Pëlqim Mjedisor, Leje Mjedisore dhe Leje Ujore, Leje Mjedisore të Integruar.

Ndërsa nëse operatori, ushtron aktivitetin pa ndonjëren nga këto dokumente është ilegal.

Ndërsa për pasurimin e thëngjillit MMPH-ja, lëshon: Pëlqim Mjedisor, Leje Mjedisore dhe Leje Ujore. Ndërsa nëse operatori, ushtron aktivitetin pa ndonjëren nga këto dokumente është ilegal.

Të këta operator ndotjet kryesore janë; degradimi mjedisor, ndotja e ajrit, ndotja e ujërave, zhurma, ndotja e tokës etj.



AKTIVITETET DEGRADUESE MJEDISORE NGA KOMPANITË QË POSEDOJNË LEJE TË AKTIVITEVE TË VEQANTA – MMPH.

Kompanitë që operojnë me leje të këtyre aktiviteteve që po i potencojmë edhe një herë sikurse:

- Seperacionet
- Gurthyesit,
- Bazat për prodhimin e betonit
- Bazat për prodhimin e asfaltit dhe
- Flotacionet,

Në të shumtën e rasteve janë degraduesit me të mëdhenj mjedisor edhe pse posedojnë leje. Rastet me të veçanta do i shpjegojmë të konkretizuara si në vijim në figurën 54 me foto 1,2 dhe 3.





Figura 54 Degradimi ambientit nga pluhuri - MMPH

Nga figura 54 në vijim MMPH apo KPMM, shqipton gjoba apo “kallëzim penal” varësisht nga niveli i shkeljes së rregullave dhe dëmit të ambientit të shkaktuar dhe obligon kompaninë që ta sanoj gjendjen e krijuar.

Kompania është e obliguar ti respektoj kriteret e vendosura nga inspektorati dhe të vendos sistemin e spërkatjes apo thithjen e pluhurit nëpërmjet filtrave dhe se shkalla e emetimit të pluhurit të jetë shumë e vogël sikurse në figurat në vijim.

Varësisht nga situata e krijuar shpeshherë ndodhë që aktivitete degraduese mund të fshehën mirëpo megjithatë tregohet nga ambienti përreth me nivelin degraduese si në figurën 55 në vijim foto 1.



Figura 55 Degradimi i ndodhur në vazhdimësi dhe gjendja faktike e ndotur mjedisore përreth impiantit - MMPH



Figura 56 Sistemi efikas i punës se sepracioneve duke përdorur sistemin e spërkatjes apo sistemin ventilues – MMPH

Figura 56 fotot 1 tregon nivelin e pluhurit të lejuar për tu emituar. Nga fotografia 1 shihet përreth ambienti shumë i pastër që dëshmon se pluhuri nuk ka emituar ndotje dhe se pasoja degraduese në malin i cili gjendet përreth tij është në parametrat e lejuar. Apo si ne foto 2 kur shihet duke funksionuar sistemi i shpluhurosje ku emetimi i pluhurit gati se është i pa përfillshem.

APK

Baza ligjore APK-së

Baza Ligjore sipas të cilës rregullohet sektori i pyjeve dhe tokave pyjore është

1. Ligji për pyje, Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës,
2. UA që derivojnë nga ky ligj dhe që specifikojnë:
 - a. obligimet,
 - b. detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit akterë duke filluar nga të drejtat e shfrytëzimit të pyjeve private, atyre shtetërore,
 - c. të drejtën për ndërrimin e destinimit të përkohshëm të pyjeve dhe tokave pyjore me qëllim kryerjen e veprimtarive të ndryshme në sektorë tjerë duke mos përfshirë edhe të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve të ndryshme që gjenden në pyje dhe toka pyjore pa marrë parasysh pronësinë.

Sipas Ligjit të lartcekur, Neni 7

7.1. Agjencinë pyjor i Kosovës menaxhon dhe administron me pyje publike si dhe është përgjegjës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e pyjeve edhe tokave pyjore private. Sipas po këtij ligji

Neni 2

2.1 nënparagrafi (b) “pyll” është sipërfaqja e tokës me bimësi drunore dhe si e tillë është e regjistruar në regjistrin kadastral”.

Ndërrim të përkohshëm apo të përhershëm të destinimit kuptohet shfrytëzimi i pyllit apo tokës pyjore për qëllime tjera, prandaj me arsyen e mbrojtjes së fondit pyjor nuk i lejohej asnjë personi fizik që posedon pyll ose tokë pyjore private që të ndryshoi destinimin pa marrë paraprakisht pëlqimin nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, kurse në rastet kur pylli ose toka pyjore është e evidentuar në emër të Institucioneve tjera shembull Komunave, pas kompletimit të dokumentacioneve të nevojshme Agjencioni Pyjor i Kosovës lëshon pëlqimin për ndërrimin e destinimit kurse Komuna detyrohet të lidh kontratë.

Në raste tjera kur prona pylli ose toka pyjore është prone shtetërore, publike, shoqërore atëherë kërkesat e personave fizik apo juridik për ndërrimin e destinimit pas kompletimit të dokumentacioneve të nevojshme dhe shqyrtimit nga Komisioni profesional i emëruar nga Krye shefi Ekzekutiv sipas procedurave të parapara me UA, Nr. 10/2010 për ndryshim plotësimin e UA, 41.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës Bujqësore, Agjencioni Pyjor nëse rekomandimi është pozitiv palës i lëshohet një pëlqim me të cilin aplikon tek Institucione tjera për pajise me dokumentacionet e nevojshme, MMPH dhe KPMM dhe pas marrjes së licencës nga KPMM dhe sjelljes së garancinë bankar Agjencioni Pyjor i Kosovë harton Kontratë në të cilën specifikohen përgjegjësitë implementuese dhe sanksionuese që burojnë nga kjo kontratë.

Asnjë person nuk guxon të filloj asnjë aktivitet të shfrytëzimit të produkteve pyjor jo drunore në pyjet publike pa qenë të pajisur me kontratë.

Ligji, Nr. 03/L-153 për ndryshim plotësimin e ligjit për Pyje Nr. 2003/3 ka deleguar tek nivelet komunale kompetencën e mbrojtjes së pyjeve së bashku me stafin që merret me mbrojtje (**rojtaret e pyjeve dhe stafin tjetër teknik**) secili rojtar i pyllit i ka të ndarë terrenin ekonomiko-pyjor të përgjegjësisë i cili fillon nga -500-1500/ha dhe është obligim i secilit rojtar që mos të lejoj asnjë person fizik a juridik qe të shfrytëzoj mineralet, gurët, zhavorrin apo edhe produktet tjera pa qen i pajisur me kontratë.

Tek pyjet dhe tokat pyjore private përgjegjësinë e mbrojtjes e ka vet pronari por sipas legjislacionit as pronari privat nuk guxon të zhvilloi aktivitete në këto pyje **pa lejen e Institucioneve lokale apo qendrore.**

Tek shfrytëzimi i pyjeve leja lëshohet nga Autoriteti komunal, kurse damkimin e bëjnë ekspertët e Agjencionit Pyjor të Kosovës kurse ndërrimin e destinimit mund ta filloi pasi të ketë marrë fillimisht pëlqimin nga Agjencioni pyjor i Kosovës pa përjashtuar obligimet që ka edhe te MMPH dhe KPMM varësisht nga natyra e ndërrimit të destinimit, shembull për minerale duhet edhe licenca e KPMM por në rast se pronari donë të zhvilloi aktivitetet hoteliere pëlqimin për nderim të destinimi e merr tek Agjencioni pyjor i Kosovës por nuk i nevojitet ndonjë dokument nga KPMM.

Te kontratat që lidhen me Agjencionin Pyjor të Kosovës për dhënien me qira të tokës pyjore për shfrytëzimin e mineraleve përveç, **rojtarrëve të pyjeve që me ligj e kanë obligim mos lejimin e punimeve pa qen të pajisur me kontratë**, në secilin kontratë është e përcaktuar edhe **Drejtoria Koordinues Regjionale e cila implementon zbatimin e këtyre kontratave.**

Inspektorati Qendror i Pylltarisë dhe Gjuetisë sipas dy ligjeve të lartcekura ka përgjegjësin e inspektimit të zbatimit të legjislacionit aktual dhe të gjitha UA që derivojnë nga këto Ligje. Më sepcifikisht obligimet detyrimet dhe përgjegjësit e Inspektoratit të pylltarisë janë të definuar në Ligjin, Nr. 03/L-029 për Inspektionin Bujqësor si dhe në UA nr. 03/2006 Për Autorizimet Kompetencat e Inspektioni Pyjor dhe Procedurat e Nxjerrjes së Vendimeve ku specifikohet se ky Inspektorat monitoron dhe Inspekton përdorimin dhe administrimin e tokave pyjore si dhënia me qira, ndërrimi i destinimit, ndërrimi i pronës, gurëthyesit, guroret, ndërtimet etj, në pyje dhe toka pyjore.

PËLQIMET, KONTRATAT-APK

Pëlqimi është i punuar në letër në formatin A4 me dizajn të përafërt siç është e paraqitur. Pëlqimi për ndërrimin e destinimit të pyllit apo tokës pyjore pa marrë parasysh pronësinë dhe përmban këto të dhëna.

- Emërtimi i Biznesit
- Nr. Regjistrimit biznesit
- Zonën kadastrale
- Ngastrë kadastrale
- Sipërfaqen e lejuar për ndërrim të destinimit
- Minimumin e shumës prej 30% nga kostoja e rehabilitimit për sjelljen e garancisë bankar
- Shumën totale të kostos së rehabilitimit sipas planit të ri-kultivimit
- Numrin e protokollit dhe datën
- Nënshkrimet e Krye shefit Ekzekutiv të Agjencionit Pyjor dhe palës.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA BUIQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

(Shtet)

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agencija za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

KL/19
Dc30.09.2019

Bazuar në nenin 23 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, në nenin 7.1. dhe 21.2 të Ligjit për Pyjet e Kosovës, ligji për tokën bujqësore me nr 02/L-26 Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr. 05/L-026, Udhëzimit Administrativ Nr.10/2010, dhe UA-Nr.01/2011, për Ndryshimin dhe Destinimin e UA Nr. 10/2010, të nenit 1, 3, 4 paragrafi 13.3, 13.5 të UA nr.10/2010 dhe Ndryshimin dhe Destinimin e UA Nr. 01/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Pyjore, Kryeshefi Ekzekutiv i APK- së, duke shqyrtuar kërkesën me shkrim të: O.P. XXXXXXXXXXXXXXX, me seli Fshati: XXXXXXX, Komuna XXXXXXXXXXXX me NRB:XXXXXXXXXXXX, përfaqësuar nga z. XXXXXXXXXXXX, Adresa:XXXXXXXXXXXX Komuna XXXXXXXXXXXX me Nr personal XXXXXXXXXXXX, me nr. e kërkesës me Nr. Arkivi 2411 dt.26.06.2019 si dhe rekomandimit të Komisionit të APK-së me NP-3889 e dt. 30.09.2019, për marrje në shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore me qira, për lejimin e zgjerimit të sipërfaqes për Shfrytëzimin e Gurit Gëlqeror, në sipërfaqe 2.50.71 ha, respektivisht 25071 m², në token pyjore të pronësisë Publike me të cilën menaxhon APK, pjesë e ngastrës kadastrale 00434-1, 00430-0, ZKXXXXXXXXXX, Komuna XXXXXXXXXXXX përkohësisht t'i jepet:

P Ë L Q I M

Për lejimin e ndërrimit të destinimit të përkohshëm, për marrje në shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore me qira, për zgjerimin e sipërfaqes, për Shfrytëzimin e Gurit Gëlqeror, në sipërfaqe 2.50.71 ha, respektivisht 25071 m², në token pyjore të pronësisë Publike me të cilën menaxhon APK, pjesë e ngastrës kadastrale 00434-1, 00430-0 ZK-SXXXXXXXXX Komuna XXXXXXXXXXXX, duke shqyrtuar kërkesën me shkrim të O.P. Nr.01/2006 "Qendrimi" SHPK me seli Fshati:Silovi, Komuna Lipjan, me NRB:XXXXXXXXX, NRB:600912150, përfaqësuar nga z. XXXXXXXX Adresa: XXXXXXXXXXXX Komuna XXXXXXXXXXXX me Nr personal XXXXXXXXXXXX me nr. e kërkesës me NP-2411 dt. 26.06.2019 si dhe rekomandimit të Komisionit të APK-së me NP-3889/19 e dt. 30.09.2019, pjesë nga ngastrë kadastrale: 00434-1, 00430-0, Kultura dhe Klasa e Tokës Pyjore, 00434-1 Kullësë e Klasës 4 dhe 5, 00430-0 Më i Klasës 5, Vendi i quajtur Çuka, Trbove, Kopja e Planit me 6 pika koordinative lëshuar ng XXXXXXXXXXXX me dt. 29.05.2019.
Promisa e ngastrës evidentohet; Druri i Kosovës, Seksioni i Pylltarisë.


Nr. prot. Data e lëshuaries së

Emërtimi i biznesit

Nr i regjistrimit të biznesit

Zonën kadastrale

Ngastrën kadastrale



Minimumin e shumës prej 30%

Sipërfaqen e lejuar per ndrrim destinimi



Shumën totale të koston rehabilitimit

Nënshkrimi i kryeshefit

Nënshkrimi i palës

KONTRATAT me Agjencinë Pyjor të Kosovës për shfrytëzimin e tokës pyjore me qira për gurore

- Emërtimi i kontratës
- Nr. Regjistrimit biznesit
- Zonën kadastrale
- Ngastra kadastrale
- Sipërfaqen e lejuar për ndërrim të destinimit
- Numrin e kontratës për lejimin e ndërrimit te destinimit
- Kohëzgjatjen e kontratës.
- Obligimet e qirasë
- Minimumin e shumës prej 30% nga kostoja e rehabilitimit, numrin e garancisë bankar
- Shumën totale të koston se rehabilitimit sipas planit të rikultivimit
- Numrin e protokollit dhe datën
- Nënshkrimet e Krye shefit Ekzekutiv të Agjencionit Pyjor dhe palës.



Numrin e protokollit dhe datën

Emertimi i kontrartës

Zonën kadastrale

Ngastra kadastrale

Nr i regjistrimit të biznesit


Sipërfaqen e lejuar për ndërrimin e

Kohëzgjatja e kontratës

Obligimet e qirasë

Minimumi i shumës prej 30% nga

Shumën totale të kosotos së rehabilitimit sipas planit të rikultivimit



Si ushtron veprimtarinë një ndërmarrje me kontratë shfrytëzimi të lëshuar nga APK-ja?

Secila ndërmarrje që ka plotësuar dokumentacionin nga të gjitha Institucionet kompetente dhe përfundimisht ka lidhur kontratë me Agjencion Pyjor të Kosovës kur prona është publike apo shoqërore dhe në emër të ish ekonomisë shoqërore me kulturë pyll ose tokë pyjore mund të filloi aktivitetin e shfrytëzimit të tokës me qira për aktivitet minerare të specifikuar në kriteret e kontratës.

Asnjë rast kur prona është publike edhe nëse është në emër të ndonjë Komune por që ka **kulturën pyll ose tokë pyjore** të gjitha procedurat janë të njëjta me të vetmin dallim se kontrata lidhet me **titullarin e pronës** dhe se shfrytëzimi fillon pas marrjes së kontratës.

Në rastet kur prona është private me kulturë pyll ose tokë pyjore normalisht se të gjitha procedurat tjera janë të njëjta me përjashtim se pala nuk ka obligim të lidh kontratë por mjaftohet me **pëlqimin për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës** pyjore lëshuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës dhe në momentin e pajisjes me këtë pëlqim KPMM i jep Licencën e shfrytëzimit apo hulumtimit varësisht nga kërkesa. Këto procedura dhe obligime i kemi i të sqaruar me KPMM edhe përmes marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur në mes dy Institucioneve.




Figura 57 Foto nga shqyrtimi i kërkesës nga komisioni për ndërrim të destinimit të tokës pyjore

A punohet në këto veprimtari edhe nga personat juridik apo fizik pa pëlqim dhe kontrata?

Ndodh të kemi raste të tilla të veprimtarive ilegale të shfrytëzimit të gurëve, zhavorrit, zakonisht në sektorin privat gjatë ndërtimit të ndonjë objekti, hapje të ndonjë rruge e që janë të karakterit të përkohshëm sa i përket afateve kohore.

Tek pronat publike aktivitete ilegale zakonisht **zhvillohen nga Kompanitë të cilat nuk përdorin minimin, por gërmimin me mekanizim**, kemi raste kur fillojnë shfrytëzimin pasi të janë pajisur me pëlqim nga Agjencioni Pyjor i Kosovës sidomos në rastet kur titullin e pronave janë Komunitat, pra shmangin lidhjen e kontratës duke i ikur edhe pagesave të qirasë me çka dëmtojnë buxhetin e shtetit dhe konkurrencën e tregut.

Nuk përjashtohen edhe rastet e veprimeve tërësisht ilegale në pronat me të cilat menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës por ato raste janë shumë të rralla dhe kjo është argumentuar edhe nga plani operativ i zbatuar nga DHKR, MMPH, KPMM dhe APK-ës-DQIPGJ, ku në tërë territorin janë hasur vetëm dy raste, madje ndaj i njëjtit ka ekzistuar një kallëzim penal për të njëjtin vend ku është hasur, kurse tjetri ka qenë veprimtari e filluar në këtë kohë.

Veprimtari ilegale konsiderohen edhe **tejkalimet e sipërfaqeve nga Operatorët Ekonomik** të cilët kanë kontrata të cilat veprime kanë ndodhur dhe kanë konstatuar edhe gjatë zbatimit të këtij plani por që numri i tyre nuk ka qenë i madh.

Si klasifikohen këto operime të jashtëligjshme- ilegale?

Për ta shpjeguar më mirë klasifikimin e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare do prezantojmë disa shembuj me përshkrim të këtyre aktiviteteve.

KLASIFIKIMI I OPERIMEVE ILEGALE MINIERARE NË PYJE DHE TOKA PYJORE- APK.

Si konsiderohet një veprimtari e jashtëligjshëm ilegale minerare sipas Ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë sektorin e pyjeve

Sipas legjislacionit aktual në fuqi veprimtari ilegale në shfrytëzimin e inerteve, gurëve, zhavorrit dhe mineraleve tjera konsiderohet:

Tek pronat private kur kultura është pyll ose tok pyjore nëse fillohet me aktivitete të heqjes së bimësisë bimore (barishtore apo drunore) e që konsiderohet ndërrim i destinimit pa u pajisur me pëlqim për ndërrim të destinimit të pyllit apo tokës pyjore nga Agjencioni Pyjor i Kosovës. Në këtë pëlqimi përmes planit të rikultivimit dhe garancionit bankar prej së paku 30% të vlerës totale të planit të rikultivimit sigurohet se ngastra pas përfundimit të shfrytëzimit do të kthehet në gjendje të mëparshme, pasi garancioni bankar mund të tërhiqet vetëm pasi komisioni ndër institucional. APK-ës, KPMH dhe MMPH jep rekomandimin e përbushjes së obligimeve nga plani i rikultivimit.

AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË HULUMTIM-APK

Kuptohen të gjitha aktivitetet që kryhen nga personat fizik e juridik në pyje dhe toka pyjore private pa u pajisur me pëlqim për lejimin e ndërrimit të destinimit të përkohshëm të pyjeve dhe tokave pyjore me të cilin dokument pala shman procedurat e rregullta të largimit të masës drunore përmes damkimit dhe pajisjes me leje të prerjes pasi procedura shkurtrohet vetëm me dhënien e flete përcjelljeve për masën drunore e dalë gjatë aktivitetit të ndërrimit të përkohshëm të destinimit, kurse për pyje publike asnjë aktivitet qoftë edhe hulumtues i cili manifestohet me veprime të largimit të shtresës sipërfaqësore me bimësi barishtore apo drunore, me hapje të rrugëve dhe aktivitetëve tjera të ngjashme konsiderohet si i jashtëligjshëm nëse personi fizik apo juridik nuk është i pajisur me kontratë. **Vetëm në raste të hulumtimit tek lokacionet kur hulumtimet kryhen përmes shpimit dhe nuk ka veprime të cilat manifestohen me heqje të bimësisë drunore e barishtore, me hapje të rrugëve apo dëmtime tjera të pyjeve mund të kryhen aktivitete hulumtuese edhe pa u pajisur me kontratë, por në pëlqimi definohen veprimet të cilat mund të kryhen pa sjellë dëmtime anësore.**

AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË SHFRYTËZIM- APK

Çdo aktivitet i fillimit të shfrytëzimit të pyjeve dhe tokave pyjore publike me qëllim të shfrytëzimit të mineraleve, dheut, gurëve, zhavorrit etj pa qenë i pajisur me kontratë nga organi menaxhues që në 90% të rasteve është Agjencioni Pyjor i Kosovës, pa përjashtuar edhe ndonjë rast kur këto prona mund të jenë me pronar tjerë, komunitat apo ndërmarrje tjera por fillimi i aktivitetëve të shfrytëzimit mund të filloi vetëm pasi pala të ketë marrë kontratën.

Tek pyjet dhe tokat pyjore private aktivitete të jashtëligjshme konsiderohen cili do aktivitet i cili ndikon në ndërrimin e destinimit të përkohshëm të pyjeve dhe tokave pyjore pa u pajisur me pëlqim për ndërrimin e destinimi nga Agjencioni Pyjor i Kosovës.

Tek pyjet dhe tokat pyjore publike përgjegjësia e mbrojtje është e deleguar në komuna të cilat përmes stafit të rojtarëve të pyjeve mbikëqyrin çdo aktivitet që kryhet duke mos lejuar shfrytëzimin pa qenë të pajisur me kontrata. Gjithashtu Inspekcioni Qendror i Pylltarisë dhe Gjuetisë përmes aktivitetëve të kontrolleve edhe inspektimeve përcjell zbatimin e akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë sektorin e pyjeve dhe në raste të hasjes së këtyre aktivitetëve ilegale me procesverbale, vendime dhe përmes vendosjes së shiritave ndalon veprimtarinë ilegale duke kërkuar fillimisht llogari nga rojtarët e pyjeve të cilët kanë të ndarë terrenet e përgjegjësisë së mbrojtjes së pyjeve edhe tokave pyjore nga çdo aktivitet ilegal.

AKTIVITETET ILEGALE ME PASOJA DEGRADUESE AMBIENTALE DHE SHKAKTIMI I RREZIKUT-APK

Pasoja e një aktiviteti ilegal në shfrytëzim manifestohet me shkaktim të degradimit të ambientit dhe rrezikut për njerëz dhe kafshë si :

- Nga shfrytëzimi ilegal dhe pa kritere i pyjeve dhe tokave pyjore shkaktohen pasoja direkte, indirekte për të tashmen dhe të ardhmen jo vetëm të sektorit të pyjeve por me ndikim edhe në sektorët tjerë
- Nga shpyllëzimi, heqja e shtresës bimore e drunore ilegalisht ndikon në zvogëlimin e fondit pyjor, ndikon në prishje të ambientit dhe peizazhit.
- Ndikon në shpëlarjen e tokës, gërryerjen (erozionin),
- Zvogëlimin e habita it të kafshëve të egra dhe shpendëve, çerdheve të tyre,
- Rrezikimin e jetës së njerëzve dhe kafshëve nga hapja e gropave dhe hendeqeve
- Dëmtimin e buxhetit të Kosovës nga mos arkëtimi i taksave për një, m² në vit 0.2/€ që do thotë për një hektar 2000/€, e dëmton konkurrencën e lirë,
- Dëmton sektorin e bujqësisë pasi do ketë erozion dhe përmytje,
- Dëmton të mbjellat dhe tokat bujqësore përmes mbushjes me gurë dhe materiale tjera inerte,
- Dëmton sektorin e ujerave dhe shtretërit e lumenjve dhe përrockave edhe shumë efekte tjera të cilat ndikojnë edhe në mikro e makro klimë duke zvogëluar kapacitetet e ujërave dhe të reshurave.



Figura 58 Heqja e shtresës së bimësisë bimore (drunore e barishtore) me efektet negative të sipërpërmendura - APK

Kjo figura 58 është në afërsi në metra me figurën 57 e mësipërme e cila do ndikon direkt në këto burime të ujit nga të cilat furnizohen qytetarët edhe në aspektin e zvogëlimit të rezervave, edhe në ndotjen e tyre.





Figura 59 Efektet nga shfrytëzimi ilegal ku dëmtohen pyjet si pasuri kombëtare dhe biodiversitetit foto 2 – APK.



Nga kjo foto 3 mënyrë e shfrytëzimit rrezikohen fshati që gjendet poshtë këtij lokacioni i cila ka paraqit edhe peticion, humbte një pejzash i mrekullueshëm, dëmtohet sektori i turizmit dhe efektet tjera negative foto 4.



Nga fotoja 4 e mësipërme në syrin e një jo profesionisti do dukej se nuk janë dëme të mëdha pasi janë pyje jo kualitative pa ndonjë vlerë ekonomike, por në fakt është e kundërta këto pyje kanë karakter mbrojtës dhe efekt teje të madh të mbrojtjes nga erozioni dhe përmbytjet.



Edhe ky lokacion foto 5 ka qenë me gjelbërim kurse tani është shndërruar në një rrezik për jeta e ndërzeve edhe kafshëve pasi do mbushte me ujë por edhe potenciali që këto inerte të përfundojnë në toka bujqësore ose në oborret e shtëpive.



Foto 6 nga shfrytëzimi pa kritere madje në pjesën e poshtëm gjendet shtrati i lumit dhe krejt ky material do përfundojnë në shtrat të lumit për të vazhduar më tutje.



Në lokacion të afërt me foton 7, efektet e shpyllëzimit me pasoja të shumëfishta.



Kur hiqet shtresa sipërfaqësore, barishtore e drunore shfaqen pasojat, foto 8.



Shumë afër liqenit të Badovcit. Foto 9 degradim i shtresës humusore –barishte.

MAPL

Legjislacioni në fuqi

- Rregullore nr. 02 / 2017 për sistemin e menaxhimit të performancës së Komunave
- Ligji për Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025

PËLQIMET, LEJET dhe KONTRATAT - KOMUNAT

Kompanitë të cilat dëshirojnë të aplikojnë për tu pajisur me leje apo licencë shfrytëzimi paraprakisht duhet të pajisen me pëlqime apo njoftimet komunale-ekstrakte dhe se parakusht është dokumenti pothuajse fillestar për tu pajisur me licence apo leje.

Komuna është përgjegjëse nga drejtorit përkatëse për lëshimin e një pëlqimi apo njoftimi-ekstrakti.

Varësisht se si është e rregulluar me organizim të komunës lëshohen këto dokumente të cilat konsiderohen se janë akte juridike.

Ky dokument (pëlqim komunal) është fillestar për kompaninë aplikuese e cila i nevojitet për kompletimin e dokumentacionit për licencë apo leje, konsiderohet si njëri prej kriterëve që duhet plotësuar aplikuesi për tu pajisur me licencë apo leje.

Për dallim nga shpjegimi paraprak për secilin institucion, komunat mund të pajisen edhe aplikant me pëlqime dhe kontrata por jo edhe me leje pune.

Kontrata, është një akt juridik i lëshuar ndërmjet palëve me interes dhe një gjë të tillë organet tjera gjegjëse të cilat kërkojnë paraprakisht këtë dokument është i pa nevojshëm për tu pajisur me leje dhe licenca.

Kur duhet pajisur kompania me nje kontrate te lëshuar nga Komuna?

Kontratat ndërmjet palëve (komuna- kompania) është dokument i lëshuar ndërmjet tyre dhe nuk duhet prezantuar institucioneve sepse është interes i palëve. Çdo shkelqje e kontratës apo mos fuqizimi apo nëse palët nuk lidhin kontratë nënkuptohet se kompania ka humbur edhe validitetin e aktit juridik –pëlqimin, njoftimin apo se i njëjti organ me të cilën ka të bëjë me fillimin e një procedure për lëshimin e lejes apo licencës duhet të njoftohet KPMM-ja se ky akt juridik është tërhequr me arsyet e tyre të argumentuara në njoftim.

Me të marre informacionin nga këto organe janë të obliguara secili institucion ta bëjë pezullimin apo revokimin e aktit juridik të lëshuar nga ata deri në qartësimin apo arsyetimin se ka bazë ligjore për tu revokuar pëlqimi.

Çka nënkuptohet tërheqje e pëlqimit apo njoftimit Komunal?

Nënkuptohet se secili akt tjetër juridik i lëshuar nga vartësia e këtij dokumenti duhet pezulluar aktin juridik pasues apo duhet revokuar deri sa janë përdorur të gjithë mekanizmat juridik tjerë- është nxjerr vendim nga gjykata apo pala ka pajtuar lidhur me tërheqjen e pëlqimit apo njoftimit, apo ekstraktit varësisht se cilin nga këto akte komuna i ka lëshuar.

Si ushtron veprimtarinë një ndërmarrje me licencë shfrytëzimi të lëshuar nga Komuna?

- a) Miniera e cila zhvillon këtë aktivitet duhet pajisur me licencë nga KPMM-ja dhe se nuk mund të zhvillohet pa pëlqim apo njoftim paraprakisht nga komuna se është pajisur me licencë shfrytëzimi figura 60.



Figura 60 Largimi i mbulesës si fazë përgatitore e fillimit të punëve minerare

- b) Nëse aktiviteti i minierës është me minim, ky aktivitet duhet pajisur me licencë nga KPMM-ja dhe se nuk mund të zhvillohet pa pëlqim apo njoftim paraprakisht nga komuna se është pajisur me licencë shfrytëzimi figura 60, 61.



Figura 61 Aktiviteti i përgatitjes së fushës për minim.



Figura 62 Aktiviteti mineralar përgatitja e fushës për minim

c) Fillimi i ndërtimit të etazheve (shkallëve punuese) figura 61 dhe 62 dhe



Figura 63 Fillimi i ndërtimit një shkalle punuese minerare

- d) Krijimi i etazheve përfundimtare dhe përgatitja për mbylljen e minierës figura 64



Figura 64 Shkallët përfundimtare, është në përgjegjësi tjera institucionale- Insp. Komunal

- e) Shkallët përfundimtare dhe ri kultivimi i minierës figura 65.



Figura 65 Rikultivimi i shkallëve të minierës me ri kultivim e aprovuar nga institucionet përgjegjëse –Insp komunal

A punohet në këto veprimtari edhe nga personat juridik apo fizik pa licencë dhe leje?

Fatkeqësisht ka persona juridik dhe fizik që këtë veprimtari e ushtrojnë jashtëligjshëm dhe në ato zona ku aktiviteti i tyre zhvillohet në sipërfaqe dhe me sistem të shfrytëzimit me gërmim kur minerali është inert apo i brishtë për tu larguar nga topografia e korës së sipërfaqes apo ka depozitime të resursit inert siç janë rërat dhe zhavorret.

Si kalsifikohen këto operime të jashligjshme- ilegale?

Për ta shpjeguar më mirë klasifikimin e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare organi kompetent ajne KPMM dhe zona ku zhvillohet ky aktivitet (komunat do bartin përgjegjësin për informatën dhe parandalimin e këtij aktiviteti pa licence ne zonën e tyre me kufizime territoriale komunale) do prezantojmë disa shembuj me përshkrim të këtyre aktiviteteve.

KLASIFIKIMI I OPERIMEVE ILEGALE MINIERARE - INSP. KOMUNAL

Si konsiderohet një veprimtari e jashtëligjshëm ilegale minerare sipas Komunes?

Aktivitetet e jashtë ligjshme dëmtim i pronës nga aktivitetet e gërmimit dhe keqpërdorimi material i resursit nuk mund të kryhet pa licence dhe leje e cila i paraprin dokumentacioni (pëlqimi apo njoftimi nga komuna) si kriter dhe se këta operatorë konsiderohen se bëjnë aktivitet minierar të jashtëligjshëm sikurse:

1. Aktivitet të jashtëligjshëm në hulumtim.
2. Aktivitet të jashtëligjshëm në shfrytëzim dhe
3. Aktivitet të jashtëligjshëm në aktivitet të veçanta

AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË HULUMTIM-INSP. KOMUNAL

Kuptohen të gjitha ato aktivitete që kryhen nga personat fizik apo juridik të cilët bëjnë aktivitete hulumtuese si:

- Pa licencë hulumtimi
- Në licencë të skaduar, mbyllura apo të pezulluar dhe
- Jashtë zonës së licencës së paraparë në kushte të vendosura të licencës.

Këso raste me aktivitet të jashtëligjshme hulumtuese nuk janë evidentuara çdo kund.

Specifike e këtyre hulumtimeve është se deri me tani nuk ka raste kur institucionet sikurse komuna është pronarë dhe se deri me tani nuk është kërkuar ndonjë aprovim parak, por nëse një veprim i tillë kërkohet që të pezullohen këto aktivitet hulumtues atëherë sipas njoftimit që i dërgohet KPMM-se këto punë hulumtuese mund të pezullohen me arsyetim apo edhe mund të vazhdojnë me kusht që prona pas fazës së hulumtimit të kthehet në gjendjen paraprake me ri kultivim.

AKTIVITETET E JASHTËLIGJSHËME NË SHFRYTËZIM- INSP. KOMUNAL

Këto aktivitet janë më të theksuara dhe kanë të bëjnë me aktivitet komerciale të resursit pa posedim të licencës nga personat juridik.

- a) Aktivitet i jashtëligjshëm në shfrytëzim konsiderohet në këto raste:
- b) Kur takohet personi fizik apo juridik me të cilën nuk prezanton para inspektoratit të komunës licencën e shfrytëzimit të lëshuar nga KPMM-ja.
- c) Kur ka aktivitet minierar eskavim-ngarkim- transport të masës së mihur me nevoja komercializimi (konstatim i komercializimit të masës së mihur brenda territorit të komunës)
- d) Kur kjo masë e mihur sipas pikës “c” nuk deponohet në ndonjë lokacion me të cilën ka pëlqim nga pronari- komuna si për mihje ashtu edhe për mbushje të masës së mihur por që nuk i dihet vend-deponimi apo deponimi nuk shkakton rrezik për ambientin në raport me vëllimin e deponuar.
- e) Komercializim i masës së minuar me aprovim nga pronari –pronë komunale ku kërkesën për minim special e ka të ri destinuar për diçka tjetër si: hapje rrugësh, sanim gjendjes krijim të niveleve të ndryshme dhe se masën e tillë e komercializon (KPMM nuk miraton minimi e tillë pa pëlqim komunal-pronari- pronë komunale)

AKTIVITET ILEGALE ME PASOJA DEGRADUESE AMBIENTALE DHE SHKAKTIMI I RREZIKUT - INSP. KOMUNAL

BAZA LIGJORE

Komunat të cilat kanë të rregulluar mirë organizimin në përputhje me ligjet dhe aktet tjera nënligjore kanë të obliguar të nxjerrin një raport vjetor i cili obligon secilën komune ta bëjë inspektimin nga degradimet ambientale të cilat ndodhin brenda territorit të Administruar nga Komuna. Kjo është e rregulluar edhe me:

- **RREGULLORE Nr. 02 / 2017 PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS SË KOMUNAVE**

Sipas kësaj rregullore dhe neneve vijuese të shpjguara si më poshtë:

Neni 2

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i ndërtimit dhe i funksionimit të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) gjatë matjes së performancës komunale, në përputhje të plotë me ligjet në fuqi dhe me dokumentin kryesor të SMPK

Neni 5

Kompetencat komunale të përfshira në SMPK

Bazuar në kompetencat vetanake të përcaktuara në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, fushat për të cilat aktualisht bëhet matja e performancës së shërbimeve komunale janë:

1.14 Mbrojtja e mjedisit.

Nga kjo bazë ligjore e shpjguar dhe nga organogrami i komunave dhe drejtorive në organizim marr nga portali i komunave përgjegjësit e tyre varësisht se si e ka të rregulluar me inspektor me drejtor të inspeksioneve apo mjedisore kanë përgjegjësitë bazike si ne vijim:

LIGJI Nr. 03/L-025

PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 3

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji është i detyrueshëm për të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, personat juridik dhe fizik, vendas dhe të huaj që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Kosovës.

Neni 5

Organet përgjegjëse për administrimin e mbrojtjes së mjedisit

3. Komunat

3.1. bëjnë aplikim të plotë të parimeve të nenit 6;

3.2. bashkëpunojnë me Ministrinë për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre sipas këtij ligji,

3.3. zbatojnë ligjet dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të tyre,

3.4. përgatisin dhe sigurojnë informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe

zhvillimin të qëndrueshëm;

3.5. planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi komunal përkatës.

Neni 81

Mbikëqyrja inspektuese

1. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji si dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij, kushtet dhe metodën e punës së personave të mbikëqyrur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj e bënë Inspektorati mjedisor i Ministrisë.
2. Mbikëqyrjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale e kryen inspektori komunal i mjedisit.
3. Ministria mundet me autorizim të veçantë, të autorizoj inspektorin komunal të mjedisit për kryerjen e detyrave tjera.
4. Punët e inspektorit mund të i kryej edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon Ministria, gjegjësisht komuna.

PERGJEGJËSIT Inspekcioni Komunal brenda territorit komunal.

1. Bën mbikëqyrjen për shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të tokës prodhuese, si dhe mbrojtjen e akumulimeve gjenetike të natyrës;
2. Propozon masat për monitorimin e cilësisë, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujit, ajrit, tokës dhe natyrën e zonës së komunës, dhe siguron zbatimin e tyre;
3. Bën mbikëqyrjen dhe inspektimin e administrimit të qëndrueshëm me vlerat natyrore, si: ajri, uji, toka, pyjet, lëndët minerale etj., të mirat natyrore publike, si: hapësirat e gjelbëruara, brigjet e lumenjve, si dhe vlerat e veçanta
4. Ndërmarrjen e masave për ruajtjen e ujërave sipërfaqësore dhe të atyre nëntokësore nga ndotësit;
5. Mbikëqyrjen e operatorëve të cilët veprojnë në territorin e Komunës, si dhe përputhshmërinë e aktiviteteve të tyre me standardet dhe normat për mbrojtje të mjedisit
6. Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aspekteve ekonomike dhe të aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
7. Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore për menaxhimin dhe eksplotimin e resurseve natyrore (prerja e pyjeve, nxjerrja e rërës nëpër lumenj etj.) nga aspekti i mbrojtjes së ambientit

Pasoja e një aktiviteti ilegal në shfrytëzim manifestohet me shkaktim i degradimit ambianti dhe rrezikut për njerëz dhe kafshë si :

Vendburimet Inerte (rërë dhe zhavorr)

- Përgjatë lumenjve kemi degradim të shtratit të lumenjve, prishjes së kadastrit të lumenjve dhe zhvendosje të lumit në zonat ku kemi dëmtim të pronës dhe rrezikut nga humbja e ujërave sipërfaqësore në tentativa të drenazhimit në ujëra nëntokësor si pasojë e dëmtimit të shtresës së dyshemesë së shtratit të lumit. (Figura 66 foto 1,2,3,4)

Inspektori i komunës, kur takon një aktivitet i tillë është përgjegjës për parandalimin e këtyre aktiviteteve dhe shqiptimin e gjobave për degradim ambianti.

Kur duhet besuar se operatori nuk ka licence?

Sepse operatorët e tillë nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre direkt në lumenj apo në raste pastrimit të lumit duhet të kenë një dokument valid të specifikuar se operatori ka leje të përkohshme nga ndonjë institucion qendror apo lokal. Në kuptimin nëse ka leje nga institucionet lokale kjo nënkuptohet se paraprakisht bëhet fjalë për komunën e cila ka aprovuar një veprim të tillë me njoftim paraprak nga institucionet qendrore.







Figura 66 Shfrytëzimi ilegal në lumenj dhe prishja e shtratit të lumit- Insp. Komunal

- Në toka punuese kemi dëmtim të pronave –tokave punuese nga kufiri (mexhanikëve) i tokave përreth si pasoj e erozionit të kufirit të zonës ku është bërë shfrytëzimi dhe dëmtim i pronës nga pronari tjetër. (Figura 67. Foto 1 dhe 2)
- Inspektori komunal është i obliguar që operatorit ti kërkohet licenca e shfrytëzimit dhe të konstatoj se degradimi pronave tjera është duke ndodhur apo se prona ku vepron operatori është pronë komunale apo aktiviteti i saj dëmton pronën komunale përreth vend shfrytëzimit.



Figura 67 Dëmtimi i arave përreth nga shfrytëzimi i rërave në toka punuese- Insp. Komunal

- Shkaktim i rrezikut nga ri-kultivimi shpeshherë pa kriter nga hedhja e mbeturinave të rrezikshme ku si pasoj mund të infektohet rrjedha e ujërave nëntokësore si rezultat i infiltrimeve të ujit nga sipërfaqja në kontakt me mbeturinat si rezultat i përzierjes e ujit të pastër me mbetjet si rezultat i kontaminimit të ujërave. (Figura 68)
- Inspektori komunal është i obliguar që operatorit ti ndalohet hedhja e mbeturinave ne gropat e shfrytëzuara. Për këtë dukuri duhet parandaluar dhe përdorur masat ligjore ndaj operatorit



Figura 68 Ri kultivimi-mbushja me bërllok i gropave te shfrytëzuara -kontaminimi i tokës me mbetje urbane – Insp. Komunal

- Shkaktimi i rrezikut nga deponi – pellgjeve ujë mbajtëse ku mund të rrezikohen njerëzit që përdoren për freski gjatë stinës së verës, rrezikim për gjuetarë gjatë stinës së dimrit si pasoj e mos konstatimit se një zonë e tillë është e thellë. (Figura 68)
- Inspektori komunal është i obliguar të marr masat sanuese dhe te identifikoj operatorin i cili ka kryer veprën penale për kanosje dhe rrezikim të qytetareve të asaj zone. Kjo i mundësohet nga identifikimi zonës ku është lënë kjo dukuri dhe të ngrit padi ndaj operatorit – pronarit të ngastrës me të cilën është kryer vepra.
- Nëse prona është komunale, komuna barte përgjegjësit për lokacioni dhe duhet të bëjë sanimin e gjendjes dhe të ri-kthej zonën në zonë të parrezikshme.



Figura 69 Krijimi i pellgjeve me ujë si pasoj e shfrytëzimit të rërave

- Rreziku i dëmtimit të shtresës së dyshemesë se toka punues si pasoj e drenazhimit të zonës përreth zonës ku është bërë shfrytëzimi. (Figura 70. Foto 1 dhe 2)





Figura 70 Shfrytëzimi i inerteve në lum, dëmtimi i shtresës dyshemore të shtratit të lumit - Insp. Komunal

- Inspektori komunal është i obliguar që operatorit ti kërkohet licenca e shfrytëzimit dhe të konstatoj se degradimi pronave tjera është duke ndodhur apo se prona ku vepron operatori është prone komunale apo aktiviteti i saj dëmton pronën komunale përreth vend shfrytëzimit.

Vendburimet të shkrifëta (argjila, rëra kuarcore, dheu dhe të ngjashme)

Për dallim nga inertet këto vendburime nuk gjenden në lumenj si përparësi, por ka anët e veta negative si:

- Në toka punuese kemi dëmtim të pronave –tokave punuese nga kufiri (mexhanikeve) i tokave përreth si pasoj e krijimit të shkallëve, lartësisë së madhe përgjatë kufirit ku në faza të vonshme kemi shembje nga mungesa e stabilitetit të shpatit të krijuar pa kriter. (Figura 69)
- Shkaktimi i rrezikut nga gropat – pellgjeve ujë mbajtëse ku mund te rrezikohen njerëzit që përdoren për freski gjatë stinës së verës, rrezikim për gjuetarë gjatë stinës së dimrit si pasoj e mos konstatimit se një zonë e tillë është e thellë. (Figura 71 foto 1 dhe 2)



Figura 71 Krijimi i deponisë me grumbull uji dhe dëmtim i kufirit të arave përreth – Insp. Komunal





Figura 72 Deponi uji nga shfrytëzimi i argjilave dhe rërave, pellgje degraduese dhe rrezik për njerëz – Insp. Komunal

- Lartësi të mëdha të krijimi të etazheve si lartësi për rrezikim nga rënia nga lartësia dhe
- Nuk behet asnjë lloje ri-kultivimi për mbylljen e hapësirës së shfrytëzuar me të cilën erozioni prish gjendjen topografike dhe krijohet imazh i keq ambiental. (Figura nga 70 deri 72)
- Inspektori komunal është i obliguar që operatorit ti kërkohet licenca e shfrytëzimit dhe të konstatoj se degradimi pronave tjera është duke ndodhur apo se prona ku vepron operatori është pronë komunale apo aktiviteti i saj dëmton pronën komunale përreth vend shfrytëzimit.

Vendburimet mesatarisht të forta (rreshpet, rreshpet kuarcore, serperntinitet, qymyret etj)

- Në shfrytëzim në sipërfaqe kemi dëmtim të pronave –zakonisht gjinden të mbjella si : shkurre nga kufiri (mexhanikëve) i shkurreve si pasojë e krijimit të shkallëve, lartësisë së madhe përgjatë kufirit ku në fazë të vonshme kemi shembje nga mungesë të stabilitetit të shpatit të krijuar pa kriter. (Figura 73. Foto 1,2,3)





Figura 73 Shfrytëzimi i qymyreve i cili bëhet pa kriter duke dëmtuar ambientin, shkaktim i rrezikut dhe dëmtim i pronave përreth vend-shfrytëzimit – Inspk. komunal

- Në disa raste varësisht nga vendburimi kemi edhe depo të grumbullimit të ujit si rrezik nga fëmijët dhe kafshët për përmbytje.
- Lartësi të mëdha të krijimi të etazheve si lartësi për rrezikim nga rënia nga lartësia . (Figura 73, 74)



Figura 74 Shfrytëzimi pa kriter, krijim lartësisë së shkallëve dhe mungesa e ri-kultivimi- Insp. Komunal

- Inspektori komunal është i obliguar që operatorit ti kërkohet licenca e shfrytëzimit dhe të konstatoj se degradimi pronave tjera është duke ndodhur apo se prona ku vepron operatori është pronë komunale apo aktiviteti i saj dëmton pronën komunale përreth vend shfrytëzimit.

Vendburimet të forta (gëlqeror të prishur tetoniksht, gëlqeror pllakor, hazburgite, serpentinite të freskëta, dunite të kollapsuara, rreshpe sericitike etj)

- Është karakteristike se këto vendburime thellësia e shfrytëzimit të tyre për dallim nga vendburimet e cekura si me lartë është e cekët dhe kemi të bëjmë vetëm me dëmtim të korës sipërfaqësore që mund të dëmtohet flora dhe ambienti.
- Lajmërimet të gropave me thellësi të cekët dhe dëmtim i imazhit ambientit sipërfaqësor. (Figura 75. Foto 1,2,3 dhe Figura 76.)





Figura 75. Shfrytëzimin operatori ilegal nuk ka arritur ta bëjë shfrytëzimin në thellësi por vetëm shtresë që e ka lejuar makineria. Degradim i terrenit dhe prishje ambientit – Insp. Komunal



Figura 76 Dëmtim i ambientit dhe rrezikim i shkallëve përfundimtare si shfrytëzim pa kriter- Insp. Komunal

- Inspektori komunal është i obliguar që operatorit ti kërkohet licenca e shfrytëzimit dhe të konstatoj se degradimi pronave tjera është duke ndodhur apo se prona ku vepron operatori është pronë komunale apo aktiviteti i saj dëmton pronën komunale përreth vend shfrytëzimit.

VEPRIMTARIA E JASHTËLIGJSHME NË AKTIVITET TË VEÇANTA- INSP. KOMUNAL

Aktivitetet e jashtëligjshme të veçanta nënkuptohen këto:

- Seperimi (Seperacionet)
- Përpunimi (Baza betoni dhe Asfalti) dhe
- Pasurimi (Flotacionet)

SEPERIMI

Seperimi ilegal nënkuptohet secili aktivitet i cili ushtron veprimtarinë e vetë pa leje dhe se ka të vendosur makinerinë në gjendje pune aktive.

Shkaktimi i rrezikut:

- Marrja e resursit mineral në përpunim nga operatorët ilegal ose me prejardhje nga vetë operatori i cili ka ndikim indirekt edhe në aktivitetet e shfrytëzimit. (Figura 77 Foto 1 dhe 2)



Figura 77 Aktiviteti i një seperim ilegal dhe marrja e resursit (rërës) në mënyrë ilegale- Inp. Komunal

- Shkaktim i ndotjes së ambientit nga pluhuri, zhurma dhe afërsia e ndërtimit të tyre afër shtëpive të banimit i pa kontrolluar dhe imipant i pa pranuar teknikisht.
- Inspektori komunal është i obliguar që operatorit ti kërkohet leja e seperacionit dhe të konstatoj se kompania është duke punuar sipas lejes se lëshuar nga organet qendrore.

PËRPUNIMI (BAZA BETONI DHE ASFALTI) - INSP. KOMUNAL

Përpunimi ilegal nënkuptohet secili aktivitet i cili ushtron veprimtarinë e vetë pa leje dhe se ka të vendosur makinerinë në gjendje pune aktive. Shkaktimi i rrezikut:

- Marrja e resursit mineral në përpunim nga operatorët ilegal- dhe aktiviteti i veçantë i seperimit ose me prejardhje nga vetë operatori i cili ka ndikim në aktivitetet të shfrytëzimit. (Figura 78 Foto 1 dhe 2)





Figura 78 Aktiviteti ilegal i bazës së betonit dhe shfrytëzimi i resursit të përpunuar nga seperacionet- Insp. Komunal

- Shkaktim i ndotjes së ambientit nga pluhuri, zhurma dhe afërsia e ndërtimit të tyre afër shtëpive të banimit i pa kontrolluar dhe imipant i pa pranuar teknikisht
- Inspektori komunal është i obliguar që operatorit ti kërkohet leja e seperacionit dhe të konstatoj se kompania është duke punuar sipas lejes së lëshuar nga organet qendrore.

AKTIVITETET DEGRADUESE MJEDISORE NGA KOMPANITË QË POSEDOJNË LEJE TË AKTIVITEVE TË VEQANTA - INSP. KOMUNAL

Kompanitë që operojnë me leje të këtyre aktivitetëve që po i potencojmë edhe një herë sikurse:

- Seperacionet
- Gurthyesit,
- Bazat për prodhimin e betonit
- Bazat për prodhimin e asfaltit dhe
- Flotacionet,

Në të shumtën e rasteve janë degraduesit me të mëdhenj mjedisor edhe pse posedojnë leje. Rastet me të veçanta do i shpjegojmë të konkretizuara si në vijim në figurën 79 me foto 1,2 dhe 3.





Figura 79 Degradimi ambientit nga pluhuri -Insp. Komunal

Nga figura në vijim Inspektorët komunal me automatizëm ndalon punën në këto veprimtari, shqipton gjoba apo “kallëzim penal” varësisht nga niveli i shkeljes së rregullave dhe dëmit të ambientit të shkaktuar dhe obligon kompaninë që ta sanoj gjendjen e krijuar.

Kompania është e obliguar ti respektoj kriteret e vendosura për parandalimin e ndotjes së ajrit dhe të vendos sistemin e spërkatjes apo thithjen e pluhurit nëpërmjet filtrave dhe se shkalla e emetimit të pluhurit të jetë shumë e vogël sikurse në figurat në vijim.

Varësisht nga situata e krijuar shpeshherë ndodhë që aktivitete degraduese mund të fshehën mirëpo megjithatë tregohet nga ambienti përreth me nivelin degraduese si në figurën 80 në vijim foto 1.



Figura 80 Degradimi i ndodhur në vazhdimësi dhe gjendja faktike e ndotur mjedisore përreth impiantit - Insp. Komunal



Figura 81 Sistemi efikas i punës se seperacioneve duke përdorur sistemin e spërkatjes apo sistemin ventilues - Insp. Komunal

Figura 81 fotot 1, 2 tregon nivelin e pluhurit të lejuar për tu emituar. Nga fotografia 1 shihet përreth ambienti shumë i pastër që dëshmon se pluhuri nuk ka emituar ndotje dhe se pasoja degraduese në malin i cili gjendet përreth tij është në parametrat e lejuar. Apo si ne foto 2 kur shihet duke funksionuar sistemi i shpluhurosjes dhe se emetimi i pluhurit gati se është i pa përfillshëm.

POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës mund të verifikoj secilin dokument apo akt juridik të secilit operator (fizik apo juridik) të kësaj lëmie për identifikimin dhe verifikimin e operatoreve në rrethana të caktuara apo të jashtëzakonshme.

Në rast se operatorit fizik apo juridik i vendosen masat e ndalesës si në vijim;

1. Konstatohet se operatori punon me aktivitet të jashtëligjshëm minerar dhe ndalesa ju është dhënë me urdhër se veprimet e tij duhet ndalen atëherë vendosen shiritat si formë e urdhrit për ndalesë. Obligohet Policia e Kosovës duhet që ta kontrolloj aktivitetin e tij se a është duke zhvilluar aktivitetin minerar.
2. Në rast se Policia e Kosovës konstaton se personit fizik apo juridik e ka larguar masën e ndalesës, ndalese në çfarëdo forme që të jetë atëherë duhet marrë masa penale për shkak të mos respektimit të ndalesës së shqiptuar.
3. KPMM-ja, inspektorati i minierave e ka të rregulluar me LMM, se ndaj operatorëve pa u bazuar se është operator i jashtëligjshme fizik apo juridik duhet lëshuar urdhrin për ndalim të aktivitetit minerar. Menjëherë njofton Policinë e Kosovës – në regjionin ku operatori ka vepruar të njoftohet se janë marr masat për ndalim të aktivitetit minerar dhe se një veprim i tillë duhet të respektohet dhe kontrollohet nga Policia e Kosovës.
4. MMPH-ja mund të marr masa për parandalimin e secilit operator për masat parandaluese apo për urdhrat e nxjerra për ndalesës të aktivitetit minerar. Ky urdhër duhet respektohet dhe të kontrollohet nga Policia e Kosovës dhe çdo veprim i masës se marr dhe është larguar pa urdhër të Inspektorit të Mjedisit konsiderohet si vepër penale.
5. Inspektoratet mjedisore- Komunale apo si komunat e kanë të rregulluar me organizim nga niveli komunal, janë të obliguar të shqiptojnë dënimet dhe të lëshojnë urdhër për ndalim të punëve në aktivitetet degraduese të gjithë operatoreve pa marr parasysh a janë operator fizik apo juridik, të cilët në çfarëdo rrethane mund të shkaktojnë degradimin apo aktivitet e tyre pa licencë apo vendim nga organi përgjegjës. Inspektoratet komunale përgjegjëse sipas kësaj pike, duhet njoftuar pas marrjes së veprimit edhe Policinë e Kosovës dhe institucionin përgjegjës se një veprim për parandalim është aplikuar. Kjo masë e parandalimit duhet kontrolluar nga inspektorët komunal dhe Policia e Kosovës.

Si duhet vepruar kur shihet një operator duke punuar me mekanizim minerar?

Secili operator që shihet se është duke punuar me mekanizim të rëndë duhet ndaluar, kërkuar dokumentacionin me të cilën operatori duhet ta posedoj me vete licencën apo lejen për ta zhvilluar këtë aktivitet.

Si mundet Policia e Kosovës ta konstatoj se një veprim i një operatori është ilegal?

Për ta konstatuar se një operator ilegal është duke punuar mund të janë shumë fakte sikurse:

- a. Operatori nuk ka licence apo leje. Nuk e dëshmon këtë me dokument siç është shpjeguar në këtë udhëzues.
- b. Operatori mund të përgënjeshtroj lokacionin duke prezantuar se ka licencë por në fakt operon diku tjetër.
- c. Operatori dëshmon ndonjë akt tjetër juridik i cili mund të jetë edhe i falsifikuar apo jo valid.

Të gjitha këto mund të jenë njohura por, si mund të verifikohen këto të dhëna?

Këto mund të verifikohen duke plotësuar formularin e bashkangjitur në figurën 82 “Formular Kontrolli”

Data:
Nr. rastit
Nr. i Policit

FORMULAR KONTROLLI

Emri, (emri i prindit), mbiemri:	Vendlindja:
Gjinia : ☐ M ☐ F	Vendbanimi, ruga dhe nr. tel:
Lokacioni:	Përshkrimi i lokacionit me ndonjë objekt përreth:

1. TË DHËNAT E OPERATORIT

Të dhënat e operatorit:	Person fizik ☐	Emri dhe mbiemri: Nr. ID.
	Person juridik ☐	Emri i kompanisë: Nr. Biznesit:

2. AKTIVITETI I OPERIMIT

AKTIVITETI	HULUMTIM	☐
	SHFRYTËZIM	☐
	AKTIVITET I VEQANTË	☐

3. STATUSI

STATUSI	POSEDON LICENCE HULUMTIM	☐	STATUSI	LEGAL	☐
	POSEDON LICENCE SHFRYTËZIMI	☐		JO LEGAL	☐
	POSEDON LEJE TË AKTIVITETËVE TË VEQANTA	☐			
	NUK POSEDON ASNIEREN NGA LICENCAT DHE LEJET	☐			

4. AKTIVITETI I LOKACIONIT DHE MINERALI

AKTIVITETI	LUMË	☐	ËKA SHFRYTËZON	LLOJ	☐
	AFËR LUMIT	☐		RËRË	☐
	AFËR RRUGË	☐		DHEU OSE ARGJILA	☐
	AFËR SHITËRIVE	☐		SHKËMBINDI TË FORTË	☐
	AFËR VENDBANIMIT	☐		QYMYR	☐

5. AKTIVITETI DEGRADUES DHE NDOTËS

DEGRADIM DHE NDOTJE	GJENDJA AKTUALE	SHËNO SIPAS NEVOJËS SHKRUTIMISHT GJENDJEN AKTUALE
	GROPË E VOGËL	
	GROPË E MADHE	
	DYSHEME E PRISHUR	
	DYSHEME E MIRË	
	LARTËSI E VOGËL	
	LARTËSI E MADHE	
	RREZIK SHEMBJE	
	RREZIK RRËSHQITJE	
	PLUHURI DHE ZHURMA	

6. MAKINERIA PUNUESE						
PERSHKRUAJ VETË ME "XK" MAKINERINË PUNJES QË KENI TAKUAR						
HULUMTIM	☐ MAKINE SHRUESE ☐ KANALE HULUMTUESE (janë të cekëta me thellësi hapje deri në 5m dhe gjatësi deri në 20 m, vetëm sa hap kanalin një lugë e ekskavatorit) ☐ PUSE TË VOGLA SHPIMI					
	MAKINERI NGARKIMI				☐ PO ☐ JO	
	TRANSPORT				☐ PO ☐ JO	
SHFRYTËZIM	7. NGARKIM DHE SHFRYTËZIM					
	ESKAVATOR	☐ (shëno sa <u>es</u> <u>ekskavator</u>)	TIPI ESKAVATORIT	Emërtimi:		
	MAKINERI SHPIMI	☐ (shëno sa <u>makineri</u>)	TIPI MAK. SHPIMIT	Emërtimi:		
	TRANSPORT					
	KAMIONA	☐ (shëno sa <u>kamione</u>)	TIPI KAMIONIT	Emërtimi:		
	KAMIONETA	☐ (shëno sa <u>kamioneta</u>)	TIPI KAMIONETES	Emërtimi:		
	8. SEPERIM, BAZË BETONI DHE BAZË ASFALTI					
	SEPERUES	☐ (shëno sa <u>seperues</u>)	SA SHIRITA	☐		
	BAZË BETONI	☐ (shëno sa baza betoni)	Sa Baza <u>Bet.</u>	☐		
	BAZË ASFALTI	☐ (shëno sa baza asfalti)	Sa Baza <u>Asfalt</u>	☐		
AKTIVITETE TË VEQANTA	LUGË NGARKUESE	☐ (shëno sa luge ngarkuese)	TIPI LUGËS	Emërtimi:		
	KAMIONA TRANSPORTUESE	☐ (shëno sa kamionë)	TIPI I KAMIONIT	Emërtimi:		
	KAMIONA BETONIT	☐ (shëno sa kamionë)	TIPI I KAMIONIT	Emërtimi:		
9. KËRKESA E ADRESUAR NGA POLICIA						
INFORMIM PËR KPMM-në				☐	PO	
VEPRIMI PËRBASHKËT POLICI- KPMM				☐	PO	
TRANSFERIM I RASTIT NGA POLICIA NË:						
KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)				☐	PO	
MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor)				☐	PO	
INSPEKTORATIT KOMUNAL				☐	PO	
Epoqë adresë e KPMM-së: icmm@kosovo-mining.org				☐	PO	
Epoqë adresë e MMPH-së : mmphurks-gov.net				☐	PO	
Nënshkrimi i Policit			Nënshkrimi i operatorit			
_____			_____			

Figura 81 Formular Kontrolli

Kush duhet plotësuar dhe çfarë do shërbejë?

Këtë formular duhet plotësuar nga Policia e Kosovës dhe mund ta adresoj tek secili autoritet shtetëror për qartësim të situatës ndaj operatorit dhe varësisht se kujt i drejtohet. Duhet dhënë informacionin kthyes mbrapa për Policinë e Kosovës.

Si duhet veproj policia e Kosovës pas plotësimit të këtij formulari?

Varësisht nga situata mund të lëshoj një urdhër për ndalesë të përkohshme deri në informacionin e marr zyrtar apo mund të marr vendim tjetër në rrethana të jashtëzakonshme.

Si kuptohet rrethana të jashtëzakonshme?

Kuptohet ku operatori është i njohur për policinë e Kosovës me herët dhe ka informata se ky nuk ka licencë askund në atë komunë apo zonë ku është atakuar.

A duhet edhe dikush tjetër të merr pjese pas lëshimit të këtij formulari kontrolli?

Formulari kontrolli plotësohet nga Policia e Kosovës ndërsa nëse kërkohet edhe asistence nga institucionet tjera duhet plotësuar dhe kërkuar ndihmë.

KONKLUSIONE DHE FALENDERIM

Janë të domosdoshme bashkëpunimet e përbashkëta institucionale dhe mekanizmat tjerë të kësaj fushe që kanë për mision parandalimin e aktiviteteve të jashtëligjshme degraduese ambientale, të cilat mundësojnë një sistem të fuqishëm institucional që prodhon rezultate konkrete për një mjedis të mirë ambientit dhe që rritë besimin tek qytetarët e Republikës së Kosovës.

Do ti rekomandonim të gjithë institucionet e përfshira në këtë udhëzues që të jetë praktik për të gjitha institucionet në mënyrë që ti harmonizojnë aktet nënligjore dhe juridike në përputhje me Legjislacionin aktual të Republikës së Kosovës.

Në përpilimin e këtij dokumenti të përbashkët ndërinstitutional punuan një ekip me përkushtim sikurse:

- **KPMM- Komisioni e pavarur për Minierat dhe Mineralet**
- **MMPH- Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**
- **MBPZHR- APK- Agjencia e Pyjeve të Kosovës**
- **MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal-Asociacioni i Komunave të Kosovës**
- **Policia e Kosovës**

Falënderim për të gjitha kontributet e mrekullueshme gjatë hartimi të këtij “Udhëzues për miradministrim të aktiviteteve minerare dhe mjedisore” ju takojnë edhe ekipit bashkë hartues në përbërje:

Jahir Gashi Inspektor i Minierave -KPMM

Bedri Halimi Kryeinspektor i mjedisit-MMPH

Besim Zogaj Drejtor i drejtoriatit qendror të inspektoratit për pylltari dhe gjueti - AKP dhe

Fadil Gashi Major, Drejtor i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda - Policia e Kosovës

